

Dësë


Viti 2 • Numri 8 • Tetor-Dhjetor 2014



Shenjtëria e
PRIVATËSISË

Arsyeja dhe Filozofia

IRI



Një notar profesionist mund të notojë në ujëra të thella pa frikë, duke shijuar në këtë mënyrë bukuritë nënujore. Nuk ka asnjë problem për një besimtar cilësor, i cili ka njohuri të mjaftueshme rreth fesë së tij, të shëtisë nëpër kulturat e popujve të tjerë. Problem është të notosh në ujëra të thella pa ditur not. E rrezikshme është të përballesh me kulturat, botëkuptimet dhe rrymat e tjera filozofike, pa pasur njohuritë e duhura rreth Islamit. Në këtë rast ekziston rreziku për të mbetur nën ndikimin e tyre.

Një tjetër problem që ka sjellë filozofia, është përpjekja e disa pseudofilozofëve dashamirë dhe admirues të filozofisë perëndimore, për ta bazuar mendimin islam mbi themele filozofike. Kjo është një përpjekje tinëzare për të vendosur arsyen mbi shpalljen hyjnore.

TË
RËNË





Kufiri i privatësisë që duhet ruajtur mes një burri dhe një gruaje është një e mirë që vjen nga Allahu... Të ruash privatësinë është qytetari... Pa këtë jeta jonë nuk ka kuptim; e tillë ajo i ngjan një tabloje të pakuptimtë të varur në mur... Respekti që tregon secila gjini për gjininë tjetër është një nga treguesit më të qartë të qytetarisë së një shoqërie.

Në një shoqëri të shëndetshme është e rëndësishme ruajtja e marrëdhënieve njerëzore...

Ligji i krijimit të çiftit... Gruaja dhe burri janë krijuar në bazë të këtij ligji... Tërheqja mes të dyve është forca më e madhe tërheqëse që ekziston.

Çdo gjë tërheqëse është me vlerë të lartë dhe si e tillë duhet mbrojtur.

Mahremjeti në një kuptim shpreh gjërat e ndaluara midis gruas dhe burrit...

Gjërat e ndaluara në Islam janë ose shumë të rëndësishme ose krejt të pa vlera. Mungesa e respektit ndaj Qabes është e ndaluar, kjo vjen nga vlera e madhe që ka Qabja... Alkooli është haram sepse pija është e dëmshme; ose mund ta shpjegojmë në këtë mënyrë: pija e shndërron mendjen e lartë dhe të nderuar

të njeriut në një dobësi të dëmshme...

Privatësia është një sekret që e rrit vlerën e asaj që është e vlefshme... Në çdo dashuri ka një sekret. Çdo sekret është i fshehur pas një fytyre. Pjesa më e madhe e njerëzve gënjehen nga kjo fytyrë. Iblisi kur shikoi fytyrën e Ademit (a.s.) tha:

"- Unë nuk i përulem atij, unë jam më i lartë se ai!"

Ai zgjodhi rebelimin para nënshtrimit. Njerëzit që mbesin në kurthin e shejtanit i gjykojnë fytyrat me anë të egos së tyre, jo me ndihmën e zemrës!..

Edhe privatësia është një provim i nënshtrimit. Fytyra e saj në këtë botë duket e shëmtuar, e zymtë dhe e mërzitshme, por në të vërtetë brenda saj ka mëshirë, qetësi dhe lumturi.

Islami është mëshirë. Kjo fe është një bekim që i jep edhe gruas edhe burrit të drejtat përkatëse. Privatësia është një dhuratë që na është ofruar nga feja jonë për të jetuar këtë jetë në mënyrë të matur... Ai njeri që e kupton këtë mrekulli dhe që mbështetet në të është i fituar, kurse ai që i del kundër është në humbje.

BOTUESI
Shtëpia Botuese "Progresi"

DREJTOR
Albert Halili

KRYERADAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj

PËRKTHYES
Ernida Kraja | Eva Kajti
Naile Sulaj

DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
L: Vasil Shanto; Rr: Çajupi
Shkodër; Shqipëri

MOBILE
+355 67 607 8484

E-MAIL
revistaetika@progresibotime.com

VITI: II
NUMRI: 8
Tetor-Dhjetor
2014

Përmbajtja



**Bota e përkohshme
dhe ajo e përjetshme**

Zahide Topçu

37



**Një këshillë, një mijë
e një mësimë...**

Osman Nuri Topbash

20



**Lotët
e Fatimes (a.s.)**

Shefika Meriç

14

**Egoja e asnjërit
nga ne
nuk është e pastër**

Fatma Hali Liman

5

**Mbylli sytë, mos të
të shikojë kush**

Neslihan Nur Turk

17

**Privatësia
është mëshirë**

Aishegyl Ballta

24

Të jesh nënë

Adem Gjynesh

30

**E bardhë do të
ishte ngjyra e
historisë sime**

Halime Demireshik

32

Vendosja e unazës

Kevseri Atar

9

**Enisa shpirtin tim
drejt qiellit**

Aishenur Vural

26

Dëshira dhe Ura

Kubra Çoban

34

**Çfarë i ndodhi
privatësisë sonë?**

Seher Ajdën

12

**Ndoshta më
shikon dhe sytë e
mi shkëlqejnë**

Fatma Allada

29

Qumshti i nënës

Dr. Betyl Inall

38

Fatma Liman

Egoja

e asnjërit nga ne

NUK ËSHTË E PASTËR



Familja, e cila duhet të jetë streha jonë e lumturisë nganjëherë mund të bëhet dhe sprova jonë më e vështirë.

Cili vend mund të jetë më i përshtatshëm se shtëpia jonë për t'u larguar nga vështirësitë e jetës së përditshme?

* * *

Në Kuran thuhet:

“Unë nuk e shfajësoj veten, sepse nefs i (i njeriut) është fort i prirur për të keqe.” (Jusuf, 53)

Nga fjalët e këtij ajeti kuptojmë se egoja brenda shpirtit është si balta që ndodhet

brenda ujit.

Brenda shpirtit të çdo njeriu ka një ujë të tillë të ndotur. Me kalimin e kohës balta ndahet nga uji dhe bie në fund, duke e lënë ujin krejt të pastër. Në këtë gjendje shpirti është i pastër plotësisht. Në momentin që ne fillojmë t'i përziejmë përsëri, uji turbullohet sërish dhe balta shpërndahet në çdo pjesë të tij.

Mendimet seksuale janë arma më e fortë e egos njerëzore, kurse organi që ndikon më shumë zemrën është syri. Syrin mund ta krahasojmë më një aparat fotografik, i cili fotografitë e bëra i ruan për t'i kujtuar më vonë; ashtu dhe syri i ruan pamjet që ka shikuar, për t'i sjellë përsëri në mendje.



Në këtë mënyrë syri merr nën kontroll arsyen e njeriut.

Gjëja kryesore që e turbullon ujin e pastër të shpirtit janë pikërisht këto fotografi të realizuara nga syri, që më pas sillen në mendje gjatë gjithë ditës duke përzier ujin e pastër me baltë.

Një ditë profeti (a.s.), grave të tij, të cilat nuk bënë kujdes për mbulesën e tyre kur në shtëpinë e tyre kishte ardhur një vizitori i verbër, u kishte thënë:

"Edhe pse ai nuk ju shikon juve, ju e shikoni atë."

Në këtë mënyrë, Ai na ka treguar se sa të rëndësishëm janë sytë. Allahu (xh. sh.), që di më së miri çdo gjë, na ka treguar kështu gjendjen e ujit të pastër që përzihet me baltën dhe më pas na ka treguar rrugën për ta mbajtur gjithmonë të pastër këtë ujë:

"O Besimtarë! Sklleverit dhe fëmijët tuj që s'kanë arritur pubertetin, le t'ju kërkojnë leje (për të hyrë) në tri kohë: para namazit të mëngjesit, kur i zhvishni rrobat në mesditë dhe pas namazit të jacisë. Këto janë tri kohë kur hiqni rrobat. Nuk ka gjynah as për ju e as për ata që, pas këtyre rasteve, të vizitoni njëri-tjetrin (pa kërkuar leje për të hyrë). Kështu jua shpjegon Allahu shpalljet juve! Allahu

është i Urtë dhe i Gjithëdijshtëm.

Kur fëmijët tuaj të arrijën moshën e pubertetit, le të kërkojnë leje, ashtu siç kanë kërkuar leje ata para këtyre. (Nur, 58-59)

Në këto ajete janë theksuar tri kohë të rëndësishme:

- 1- Koha para namazit të sabahut,
- 2- Koha kur heqim rrobat në drekë

3- Nata, pra pjesa e ditës pas namazit të jacisë.

Sipas një transmetimi të Atabin Jesarit kur një nga shokët e Profetit i kishte thënë se i dukej e panevojshme kerkimi i lejes së të ëmës për të hyrë në dhomë. Pejgamberi i kishte përsëritur disa herë se kjo ishte diçka që duhet bërë. Në fund të bisedës, për t'ia shpjeguar më mirë, i kishte thënë:

"Kërko leje nga nëna jote.." (Shiko: Muvatta, Istizan, 1)

Përderisa njeriu duhet të jetë i kujdesshëm edhe kur ndodhet pranë krijesës së tij më të afërt, pranë nënës, kuptojmë që kjo është një çështje shumë e rëndësishme.

* * *

Për ta mbajtur të pastër ujin e shpirtit nga balta, duhet të kemi kujdes me çdo gjë që e ndot këtë ujë. Për shembull:

Nëna dhe babai duhet ta bëjnë çdo gjest përkëdheljeje larg syve të fëmijëve, në dhomën e tyre.

Një nga arsyt kryesore të përzierjes së ujit me baltën janë mendime të tilla, si:

"Le të jenë fëmijët dëshmitarë të dashurisë që prindërit kanë për njeri - tjetrin."

"Fëmijët lumturohen kur shikojnë që prindërit e duan njëri - tjetrin."

Fëmijët që mbushin moshën 7- vjeçare duhet të flenë në shtretër të ndarë. Nëse nuk ekziston mundësia për një gjë të tillë, duhet të mbulohen me mbulesa të ndara.

Nuk duhet të futemi në dhomën e fëmijëve pa trokitur në derë dhe duhet t'i mësojmë edhe ata që të trokasën dhe të kërkojnë leje për të hyrë në një dhomë.

"A jemi në zyra pune? Çfarë nevojë ka për kaq shumë formalitete? Le të jemi të lirshëm të paktën në shtëpi, në familjen tonë. Mos ta vështirësojmë jetën, ta lehtësojmë atë." Këto mendime nuk janë asgjë tjetër veçse mosdhënia rëndësi e baltës që ka shpirti ynë.

Në shtëpi është haram nxjerrja në pah e pjesës së trupit mes gjoksit dhe gjurit edhe para njerëzve me të cilët e kemi të ndaluar martesën. Duhet të kemi kujdes me veshjen tonë edhe përpara të afërmeve.

Kjo lloj edukate u duhet dhënë fëmijëve tanë para periudhës së adoleshencës.

Të thuash: *"Zemra juaj është e ndyrë, zemra jonë është e pastër. Le të kenë kujdes ata të cilët nuk e kanë zemrën e pastër!.."*, është të pranosh që nuk e kuptoni aspak realitetin.

Askush nuk mund ta dijë pastërtinë e zemrës së dikujt tjetër. Ne nuk mund t'i besojmë as zemrës sonë, sepse egoja na drejton gjithmonë drejt së keqes dhe na bën të devijojmë nga rruga e drejtë. Fakti se nuk mund ta dimë asnjëherë se çfarë mban zemra e një njeriu tjetër, është një e vërtetë e pakontestueshme.

Gjithashtu, nuk duhet t'i lejojmë fëmijët të bëjnë banjo bashkë dhe në moshën

*Nuk duhet të futemi
në dhomën e fëmijëve pa
trokitur në derë dhe duhet
t'i mësojmë edhe ata që të
trokasin dhe të kërkojnë leje
për të hyrë në dhomë.*

kur ata janë në gjendje të lahen, duhet t'i lejojmë të lahen vetëm.

Feja jonë është e tillë, që i jep shumë rëndësi mendjes dhe logjikës. Islami nuk është një fe që bazohet në romanticitet të pakuptimtë. Ajo na sugjeron të marrim masa për çdo gjë. Çdo gjë që na ndodh mbasi ne i kemi marrë masat, pra kemi bërë çdo gjë që kishim në dorë, duhet pranuar si fat i joni.

Kur dalim nga shtëpia, e fikim edhe pajisjen elektronike më të përparuar. Duke pasur frikë se mos digjet shtëpia jonë nga një qark i shkurtë që mund të ndodhë, ne marrim masa duke i fikur të gjitha pajisjet elektronike kur nisemi për pushime.

Gjithashtu, ne sigurojmë makinat tona, shtëpitë dhe gjëra të tjera. Sa çmime të mëdha parash harxhojmë për të gjitha këto. Shkurtimisht mund të themi se ne mundohemi të sigurojmë çdo gjë në jetë. Sa patetik është fakti që ne nuk përpiqemi të marrim masa për gjëra të cilat na bëjnë të fitojmë kënaqësinë e Krijuesit tonë dhe nxjerrim si justifikim pastërtinë e zemrës sonë...

Allahu mos na lëntë vetëm me egon tonë, sepse egoja e asnjërit nga ne nuk është e pastër!..





Vendosja

Kërsër Atar

E UNAZËS

Pejgamberi (a.s.) dhe shokët etij të bekuar pasi kaluan trembëdhjetë vite shumë të vështira në Meke shtegtuan për në Medine dhe themeluan aty: “Shtetin Islam të Medinës”. Kjo ishte një aleancë politike e krijuar mes fiseve të ndryshme që jetonin në Medine dhe në rrethinat e saj. Sigurisht që kryetari i këtij bashkimi politik ishte Pejgamberi ynë i nderuar. Marrëveshja e shkruar në të cilën përmendet emri i Tij ka mbërritur deri në kohët e sotme dhe është **“Kushtetuta”** e parë e njohur. Një veçori e kësaj marrëveshje është fakti se në të janë përcaktuar kufijtë e shtetit Islam të Medinës.

Kishin kaluar shtatë vjet qëkur myslimanët ishin vendosur në Medine dhe kishin krijuar shtetin Islam kur Pejgamberi (a.s.) vendosi që t’i dërgonte nga një letër shteteve fqinjë për t’i bërë ftesë në Islam. Sigurisht që njohja e një shteti të ri nga shtetet tjera është shumë e rëndësishme.

Mbas përgatitjes së letrave që i bënë thirrje shteteve fqinjë për të përqafuar islamin lindi një problem;

Disa nga sahabët iu drejtuan Pejgamberit me fjalët:

“ - O i Dërguar i Allahut!.. Drejtuesit e shteteve nuk i pranojnë letrat që nuk kanë vulë. Ato nuk i marrin parasysh letrat që u nisen pa vulë, ia nisim kot!..”

Pejgamberi ynë e mori parasysh këtë këshillë dhe kërkoi përgatitjen e një vule menjëherë. Përpara kësaj ndodhie në Hixhaz (zona e Mekes dhe Medines) nuk ishte përdorur vulë. Sipas transmetimeve mësohet se kjo vulë ishte prej argjendi. Në të gjendej shkrimi: “Profeti Muhammed” , më vonë kjo vulë u kthye në unazë dhe filloi që të përdorej nga Pejgamberi ynë. Kjo ishte hera e

parë që Pejgamberi ynë vendosi një unazë në gisht. Disa prej sahabëve kërkuan që të bënin të njëjtën gjë, të prodhonin një unazë të ngjashme dhe ta vëndosnin në gisht; por duke qenë se kjo unazë ishte simboli i shtetit Pejgamberi ua ndaloi këtë gjë sahabëve të vet duke i thënë:

"Askush të mos bëjë një unazë që i ngjan unazës që mbaj unë." (Buhari, VII, 53; Ebu Davud, IV, 125.)

Pas vdekjes së Pejgamberit salallahu (a.s.) i kaloi Hz. Ebu Bekrit (r.a.) pas tij i kaloi Hz. Omerit (r.a.) pastaj i kaloi Hz. Osmanit (r.a.). Sipas transmetimeve, kjo unazë i humbi Hz. Osmanit (r.a.) duke i rënë në pusin Eris në vitin e tij të gjashtë si kalif.

Kalimi i kësaj unaze në duart e këtyre njerëzve tregon se ajo nuk ishte një send personal por pronë e shtetit islam.

Nga ky shpjegim kuptojmë se Pejgamberi (a.s.), nuk e kishte ndjerë asnjëherë nevojën e të mbajturit unazë, por e kishte vendosur atë vetëm si një detyrim që i lindte nga të qenurit kryetar shteti. Duke u nisur nga kjo dijetarët Hanefi kanë thënë:

"Nëse nuk është e nevojshme është më mirë që të mos vendoset unazë pavarësisht materialit nga i cili është prodhuar; kurse për njerëzit që kanë poste të tilla si kadi, sulltan etj, mbajtja e unazës është sunet."

CILI ËSHTË VENDIMI PËRSA I PËRKET BURRAVE QË VENDOSIN UNAZË ARI?

Sipas fesë sonë mbajtja e unazave ari nga burrat është e ndaluar. Për të shpjeguar këtë temë mund të përmendim këto raste.

Sipas transmetimit të Abdullah bin Omerit (r.a.) unaza e para që vendosi në gisht Resulullahu, (a.s.) ishte prej ari. *Sahabët gjetën nga një unazë ari dhe e vendosën në gisht për t'i ngjarë Atij. Kur e shikoi këtë gjë Pejgamberi ynë e nxori unazën e vet nga gishti dhe tha:*

"- Nuk do ta vendos kurrë më këtë unazë!.."

Edhe shokët e Profetit vepruan në të njëjtën më-

nyrë duke i nxjerrë nga gishti unazat." (Buhari, VII, 53; Ebu Davud, IV, 128.)

Abdullah bin Abbasi ka transmetuar:

"Një ditë Pejgamberi (a.s.), shikoi një unazë ari në gishtin e dikujt. Ia nxori nga gishti menjëherë dhe e hodhi duke i thënë:

"- Si ka mundësi që njëri nga ju merr një copë zjarrri dhe e vendos në gishtin e tij?"

Kur iku Pejgamberi (a.s.), i thanë burrit:

"Merre unazën që Ai hodhi dhe shite atë në mënyrë që të përfitosh prej saj."

Ai iu përgjigj:

"- Jo, unë betohem në Allah se duke qenë se Pejgamberi salallahu (a.s.), e hodhi atë unazë unë nuk e marr më atë!.." (Muslim)

Ndërkohë nuk ka asnjë transmetim që të tregojë se ka ndalimi edhe për gratë në lidhje me vendosjen e unazave. Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

"Mëndafshi" dhe ari janë të ndaluar për burrat e umetit tim dhe janë të lejuara për gratë e umetit tim." (Tirmidhiu, Libas, 1.)

Ditët e sotme na ofrojnë shumë mundësi shkencore për të bërë kërkime në lidhje me këto çështje dhe përsëri ato na kanë treguar se të gjitha ligjet

e islamit janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që të jenë në dobi të njeriut. Sipas hulumtimeve të bëra, ari rrit sasinë e hormonit të estrogenit, hormoni i feminitetit. Përdorimi i arit nga burrit bën që tek ato të rriten tiparet femërore. Siç e dimë Islami e ka ndaluar përdorimin e arit shëkuj më përpara para se të bëheshin këto kërkime shkencore.

Duhet të kemi parasysh se përdorimi i arit është i lejuar vetëm në ato raste kur përdoret për arsye shëndetsore, për arsye shërimi. Si shembull mund të themi se përdorimi i dhëmbëve të mbështjellur me ar është i lejuar... Arfexhe bin Esad (r.a.), tregon:

1. Korigjuar nga numri i kaluar.



"Në kohën e injorancës në luftën e Kulabit m'u dëmtua hunda prandaj më vendosën një hundë prej argjendi, por kjo filloi të mbante erë. Kur ia shpjegovë këtë gjëndje Pejgamberit (a.s.), më tha që të bëja një hundë prej ari." (Ebu Davud, Hatem 7; Tirmidhiu, Libas, 31; Nesai, Zinet 41.)

VENDOSJA E UNAZAVE PREJ ARGJENDI NGA BURRAT

Vendosja e unazave prej ari nga një burrë është e ndaluar, por nuk ka asgjë të keqe nëse një burrë vendos unazë prej argjendi. Sipas transmetimit të Enes bin Malik (r.a.), është shikuar shumë qartë përdorimi i unazës së argjentë nga Pejgamberi (a.s.). sikur përdorimi i unazës prej argjendi të mos ishte i lejuar, Pejgamberi ynë i nderuar nuk do ta kishte vendosur kurrë atë.


Duhet të kemi parasysh se nëse vendosja e unazës prej argjendi nuk është haram nuk mund të themi të njëjtën gjë për të gjithë sendet e tjera prej argjendi; pra nuk është e lejuar që një burrë të vendosë vathë, varëse, byzyluk apo diçka tjetër prej argjendi. Kur burri përdor diçka të tillë përveç unazës, ai i ngjan femrave. Resulullahu (a.s.), ka thënë:

"- Allahu i mallkoftë gratë që përpiqen t'u ngjasojnë burrave dhe burrat që përpiqen t'u ngjasojnë grave!.."

Nga ky hadith kuptojmë se përdorimi i këtyre objekteve nga burrat është i ndaluar.

A MUND TË VENDOSIN UNAZË GRATË?

Islami është një fe e cila nuk vendos ndalime për të vështirësuar jetën e njerëzve vetëm nëse ato bien ndesh me parimet kryesore të saj. Gratë janë shumë të dhëna pas paraqitjes së jashtme, ato dëshirojnë që të duken bukur prandaj zbukurimi i grave me ar, argjend, gurë të çmuar apo gjëra të



SHKRIMET NË UNAZAT E NJERËZVE TË MËDHENJ TË ISLAMIT

Edhe katër halifet përdornin unaza prej argjendi, në to ishin shkruar këto fraza:

Në unazën e Hz. Ebu Bekrit (r.a.), ishte shkruar: **"Sa i fuqishëm është Allahu"**

Në unazën e Hz. Omerit (r.a.) ishte shkruar: **"Vdekja është e mjaftueshme si këshillë"**

Në unazën e Hz. Osmanit (r.a.), ishte shkruar: **"Ose do të tregohesh i duruar para problemeve dhe fatkeqësive ose do të pendohesh"**

Në unazën e Hz. Aliut (r.a.), ishte shkruar: **"Pasuria është pronë e Allahut."**

Në unazat e disa prej dijetarëve ishin këto shkrime:

Në unazën e imamet Ebu Hanife: **"Ose fol për të mirë ose hesht"**

Në unazën e Ebu Jusufit: **"Kush vepron duke ndjekur ndjenjat do të pendohet"**

Në unazën e imam Muhammedit: **"Ai që duron ka sukses"**

tjera të ngjashme është i lejuar. (Prof. Dr. Hajreddin Karaman, Fetva)

Nga ana tjetër nuk është e pranueshme që gruaia t'i shfaq këto objekte zbukurimi para burrave të huaj. Në Kuran thuhet:

"Thuajti besimtareve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara), ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme) dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme." (Nur, 31)

A KA NDONJË RËNDËSI NGA ANA E FESË MATERIALI NGA I CILI ËSHTË BËRË UNAZA?

Byrejde (r.a.), tregon:

Një njeri i cili mbante një unazë të bërë nga hekuri iu afrua Resulullahut (a.s.).

Kur e shikoi këtë unazë Pejgamberi tha:

"Pse shikoj që disa nga ju mbani një pjesë nga familja e zjarrit?!"

Burri menjëherë e nxorri unazën nga gisht dhe e hodhi atë.

Një ditë tjetër erdhi pranë Pejgamberit (a.s.) dhe në dorë mbante një unazë prej bakri.

Resulullahu (a.s.), i tha:

"Pse dëgjoj tek ti erën e idhujve?!"

Më vonë ky njeri erdhi pranë Pejgamberit me një unazë floriri në dorë. Këtë herë Pejgamberi i tha:

"Pse shikoj që ti po mban një zbukurim që i takon njerëzve të xhenetit?"

Burri e pyeti:

"Nga cili material duhet të jetë unaza ime atëherë?"

Pejgamberi (a.s.) iu përgjigj:

"Le të jetë nga argjendi dhe të mos e kalojë peshën e 4.7 gram." (Tirmidhi, Libas 43)



Çfarë i ndodhi privatësisë sonë?

Kthimi i botës sonë në një fshat të vogël me anë të globalizimit; tregtia dhe teknologjia që fituan një shpejtësi të papritur me anë të zhvillimit të komunikimit, na kanë sjellë me vete edhe shumë zjarre të tjera. Këto zjarre nganjëherë i djegin familjet nga brenda, kurse disa herë të tjera na i kthejnë fëmijët tanë në njerëz që nuk i njohim më.

Tashmë nuk e njohim më njëri- tjetrin. Fëmijët, të cilët i kemi rritur me duart tona tashmë, në këto kohë moderne kanë marrë lirinë për të na gjykuar dhe qortuar neve. Gjyshet tona, të cilat nga respekti që kishin, e mbyllnin gojën para burrave, tashmë kujtohen si diçka antike. Në ditët e sotme televizioni dhe interneti janë bërë mënyra më e përdorur për të bërë njohje mes vajzave dhe djemve, të cilët më pas do të themelojnë një familje të re.

Me modernizimin e jetës çdo gjë ka degjeneruar, as kuptimi i privatësisë nuk i ka shpëtuar kësaj. Në krye të kësaj ndër marrëje sigurisht që qëndrojnë ata të cilët kanë më shumë të drejtë për të folur dhe që dëgjohen më shumë në shtëpitë tona: televizioni dhe kompjuteri. Këto dy pajisje elektronike çdo ditë mundohen që të çajnë perden e privatësisë së jetës të secilit nga ne. Njerëzit të cilët nuk do t'i lejonim që të fusnin këmbë në shtëpinë tonë, i presim si mysafirë çdo ditë. Shumë herë u bëhemi spektatorë nganjëherë edhe partnerë të gjesteve të tyre. Nga ana tjetër, shkollat e përbashkëta (djem dhe vajza

bashkë) dhe shumë gjëra të tjera që na i dhuroi jeta moderne, e grisën edhe më shumë perden e privatësisë. Të gjitha pasojat e këtyre gjërave i pësoi shoqëria jonë, në veçanti fëmijët tonë.

Një ditë Pejgamberi ynë ka thënë:

"Do të vijë një kohë, kur shejtani do të jetë ortak me njerëzit në edukimin e fëmijëve të tyre."

Kur e pyetën:

"O i Dërguar, a do të ndodhë me të vërtetë një gjë e tillë?"

Resulullahu dha këtë përgjigje:

"Po."

Kur shokët e pyetën:

"Mirë, po si do ta kuptojmë ne që kemi ortak shejtanin në edukimin e fëmijëve tanë?"

Pejgamberi i ishte përgjigjur:

"Kur të shikoni që tek fëmijët tuaj është zvogëluar ndjenja e turpit, e mëshirës dhe keqardhjes kuptoni që shejtani ju është bërë ortak në edukimin e tyre!.."

(Kenzyl Ummal, Kitabul Ahlak, 5793)

Feja islame nuk mjaftohet me ndalimin e së keqes, por ajo ka si parim kryesor edhe urdhërimin për të mirën; ajo ka si qëllim mbylljen e të gjitha rrugëve që të çojnë në gabim. Me dhënien e ndershmërisë njeriut, feja jonë synon që ta ruajë zemrën dhe syrin e tij nga çdo rrezik. Përsëri për të mirën

dhe për shpëtimin e njeriut feja islame e rrethon atë me sekretin e privatësisë, e ruan njeriun ashtu siç ruhen gurët e çmuar...

Një ditë në Medinë, një grua erdhi pranë Pejgamberit (a.s.) dhe e pyeti:

"O i Dërguar, nëse jam në dhomën time dhe kam veshur një veshje me të cilën nuk do të doja të më shikonte as babai, as fëmija im dhe dikush vjen pa prituri, çfarë duhet të bëj?"

Pas kësaj u zbrit ajeti:

"O besimtarë! Mos hyni në shtëpitë e huaja pa marrë leje e pa i përshëndetur banuesit e tyre. Kjo është më e mira për ju. Ndoshta do t'ia vini veshin! Nëse atje nuk gjeni askënd, mos hyni derisa t'ju lejohet e, në qoftë se ju thuhet, "Kthehuni", atëherë kthehuni! Kjo është më e mirë për ju. Allahu e di se çfarë bëni ju." (Nur, 27-28)

Si çdo këshillë që Pejgamberi ynë, mbreti i zemrave e shpjegonte gjatë e gjatë dhe pa përtesë; kërkimin e lejes për të hyrë në një dhomë e shpjegon kështu:

Xhabir bin Abdullah (r.a.), kishte shkuar një ditë tek shtëpia e Pejgamberit (a.s.) për të folur në lidhje me borxhet e babait të tij. I ra derës dhe Pejgamberi i nderuar (a.s.) e pyeti:

"Kush është?"

Xhabir (r.a.), iu përgjigj:

"Unë."

Pas kësaj, Pejgamberi e përsëriti tri herë, duke thënë:

"Unë, unë, unë!.."

Dhe e këshilloi me këto fjalë:

"Si mund të kuptoj se kush është nga kjo përgjigje?" (Buhari, Istizan, 17)

Transmetohet që Omeri (a.s.), i kërkonte leje në këtë mënyrë Pejgamberit:

"Selam, o i Dërguar, Unë jam Omeri! A mund të hyj?" (Ebu Davud)

Feja jonë, e cila i jep shumë rëndësi privatësisë së njeriut, i këshillon pjesëtarët e familjes që të kërkojnë leje për të hyrë tek dhoma e dikujt tjetër; gjithashtu duhet të kemi kujdes për të mos prekur gjërat personale të një njeriu, tjetër pa marrë leje prej tij.

Sipas një transmetimi të Abdullah Ibn Abbas (r.a) Pejgamberi (a.s.), ka thënë kështu:

"Kush shikon letrën e vëllait të vet pa i marrë leje atij ka shikuar zjarrin." (Ebu David, Salat 358)

Një pikë tjetër, e cila kërkon kujdes të veçantë,

është edhe privatësia e prindërve, edhe pse bëhet fjalë për vetë nënën tonë që na ka shërbyer gjithmonë.

Një ditë një njeri e pyeti Pejgamberin (a.s.), në lidhje me këtë çështje:

"Kur shkoj pranë nënës, a duhet të kërkoj leje?"

I Dërguari tha:

"Po!"

"Por unë jetoj në të njëjtën shtëpi me të."

Pejgamberi i nderuar i tha:

"Kërko leje për të hyrë në dhomën ku qëndron ajo."

Pas kësaj, ai njeri pyeti:

"Por ajo më shërben mua."

Pejgamberi i dha këtë përgjigje:

"Kërko leje nga nënë jote. A je dakord që ta shikosh të zbuluar atë?"

Personi që po e pyeste, i tha:

"Jo!"

Pas kësaj, Pejgamberi (a.s.), përsëriti fjalinë:

"Kërko leje prej saj!"

Sulltani i dy motrave ka thënë kështu, në lidhje me personin që vëzhgon një njeri tjetër në fshehtësi:

"Nëse dikush vëzhgon shtëpinë tënde dhe ti i plagos syrin atij, ty nuk të llogaritet asnjë mëkat." (Muslim, Buhari)

Feja islame i jep shumë rëndësi njeriut dhe familjes, prandaj na ka mësuar ne rregullat e edukatës. Allahu na i ka vënë në shërbimin tonë të gjitha gjallesat dhe në të njëjtën kohë kërkon që të na ruajë ne nga shikimet e dëmshme.

Nuk duhet të harrojmë se çdo gjë që ruhet dhe për të cilën bëhet kujdes, është shumë me vlerë dhe e çmuar...



Lotët e Fatimes



Çdo ditë me Të ishte një kopsht trëndafilash. Vetë trëndafilat merrnin shembull nga Ai... Të gjithë njerëzit që e ndoqën dhe ecën në rrugën e Tij, duke e marrë shembull Atë, njeriun më të lartë; arritën t'u ngjanin trëndafilave...

Në një vend ku foshnjat vajza vriteshin, pasi konsideroheshin si një turp për familjen, një baba puthte duart e vajzës së Tij dhe ngrihej në këmbë kur ajo vinte. Në këtë mënyrë Pejgamberi ynë na tregonte se sa e rëndësishme është femra në Islam.

Në një bashkësi ku edhe puthja e fëmijëve djem ishte turp, Pejgamberi (a.s.), i puthte duart dhe ballin Fatimes. Ai e donte shumë Atë. Kur fliste për të shprehej në këtë mënyrë:

"Ai që e lumturon Fatimen më lumturon dhe mua, Ai që zemëron Fatimen më zemëron edhe mua."

"Fatimja është pjesë e imja. Kush e mërzi atë, më ka mërziur mua. Ai që më zemëron, mua ka zemëruar Allahun."

Pejgamberi i nderuar ishte jetim. Atij i vdiq edhe xhaxhai, pastaj edhe gruaja e Tij, Hatixhe... Vetëm ajo i kishte mbetur nga Hatixhja... "Vajza e babait" e quante atë.

"T'u bëftë babai kurban!" - i thoshte.

Fatma e vogël e donte shumë babain e vet dhe kujdesej për Të, kujdesej me mëshirën e një nëne. Ajo e kaloi fëmijërinë e vet në një periudhë kur feja islame ishte shumë e dobët dhe myslimanët shtypeshin më shumë se kurrë.

Një ditë, një nga politeistët, kur e shikoi Pejga-

mberin në rrugë i hodhi mbeturina. Resulullahu (a.s.), u largua pa thënë asgjë dhe u drejtua nga shtëpia. Fatma (r.a.), kur e shikoi babain e saj në këtë gjendje, vrapoi për t'i sjellë ujë; pastaj me lot në sy lau fytyrën dhe kokën e babait së saj. Pejgamberi (a.s.), tha kështu:

"Bija ime, mos qaj! Mos ki frikë, sepse Allahu (xh. sh.), do ta ruajë babain tënd nga veprat e këqija të armiqve dhe do ta bëjë fitimtar ndaj tyre."

Pejgamberi ynë i nderuar ishte trëndafili i gjithësisë, kurse Fatimja ishte një gonxhe...

Resulullahu ishte shpirti i botës e shpirti i Tij ishte Fatimja...

Ajo ishte njeriu më i afërt, vajza me të cilën ai qante hallet... (Asr-i Saadette)

Sa herë që vëzhgojmë skenat ku na paraqitet Pejgamberi (a.s.), sigurisht që do të shikojmë edhe Fatimen (r.a.), sepse në çdo kujtim në lidhje me të Dërguarin ka pjesë edhe Fatimja, bija e Tij e dashur. Nëse e shikoni Fatimen, do të gjeni me siguri shenja të Pejgamberit tonë të dashur...

Fatimja është bija e më të nderuarit Pejgamber dhe nëna e dy gurëve të çmuar: Hasanit dhe Hy-senit... Ajo është edhe gruaja e një njeriu të lartë: Hz Aliut (r.a.).

Jeta e Fatimes ishte po aq e vështirë dhe me vuajtje, sa ajo e Pejgamberit tonë. Ajo qëndronte gjithmonë në krah të Tij në çdo vështirësi dhe ishte si një dritë shprese për Të.

Pejgamberi ynë gjithmonë, para se të nisej për një udhëtim, shkonte të takonte bijën e vet dhe



kur kthehej përsëri, e vizitonte atë të parën.

Një nga momentet më shqetësuese në jetën e një njeriu është vdekja. Ky moment është i vështirë, jo vetëm për njeriun që largohet nga kjo botë, por edhe për të afërmit e vet që i lë pas. Edhe në këtë rast le të kujtojmë Pejgamberin (a.s.). Ai ka qëndruar mbi varrin e bijës së vet Rukijes, pranë Tij qëndronte edhe Fatimja me lot në sy. I Dërguari i Allahut i fshinte lotët e vajzës së vet me një copë të vogël.

Pejgamberi (a.s.), ishte pranë fëmijëve të vet jo vetëm në raste gëzimi, por edhe në hidhërime. Ai u qëndroi pranë vajzave të veta në çdo etapë të martesës, që nga zgjedhja e dhëndrrit, deri tek përgatitja e dasmës.

Lidhja që ekzistonte mes Pejgamberit (a.s.) dhe Fatimes (r.a.), nuk mund të shpjegohet me fjalë. Ai kishte ndjekur me kujdes çdo etapë të vajzës së shtrenjtë.

Kur zgjodhi si dhëndër Aliun (r.a.), Pejgamberi i tha kështu vajzës së vet:

"Fatime, të martova ty me më të zgjuarin, më të maturin, më të diturin dhe me atë që ka pranuar i pari fenë islame."

Pas vdekjes së nënës së saj shumë të dashur, Hatixhes, Fatimja, duke qenë edhe në një moshë të vogël, nuk ishte ndarë kurrë nga babai i saj. Nganjëherë të dy kapeshin dorë për dore dhe

shëtisnin nëpër rrugët e Mekës. Nganjëherë ajo i vihej pas babait të vet dhe mendohej ta mbronte Atë nga torturat e politeistëve.

Një ditë kishte shkuar me babain e vet në Qabe. Kur i shikuan ata, jobesimtarët u mblodhën dhe filluan të pëshpëritnin me njëri-tjetrin. Babai i dashur filloi të falte namazin. Kur ishte në sexhde, jobesimtari i urryer Ukbe ibni Ebi Muajt i hodhi Atij në shpinë zorrët e një deveje. Të gjithë filluan të qeshnin dhe të talleshin me këtë situatë. Fatimja me lot në sy dhe shumë e zemëruar filloi ta pastronte babain e nderuar. Pejgamberi i gjithësisë e ngriti kokën nga sexhdja dhe duke iu drejtuar njerëzve të pamëshirshëm, tha:

"O Allahu im, i lë në dorën Tënde këta njerëz të pamëshirshëm. O Zoti im! Po t'i lë Ty Kurejshët."

Abdullah ibni Mesud (r.a.), e tregon kështu fundin e këtyre njerëzve, që u sollën keq ndaj Pejgamberit tonë:

"Ata jobesimtarë të pamëshirshëm i shikova në Bedër. Të gjithë ishin masakruar në luftë. Një pjesë e tyre ishin zvarritur për t'u hedhur në pusin e Bedrit."

Fatimja ishte shpeshherë dëshmitare e këtyre torturave, duke qenë se ishte përherë pranë babait të dashur. Një ditë tjetër ata kishin mbërritur në Qabe. Politeistët e kishin rrethuar Pejgamberin (a.s.) dhe kishin filluar ta fyenin:



*Jeta e Fatimes ishte po aq
e vështirë dhe me vuajtje, sa ajo
e Pejgamberit tonë. Ajo qëndronte
gjithmonë në krah të Tij
në çdo vështirësi dhe ishte si një
dritë shprese për Lë.*

"A nuk je ti ai që thotë këtë, atë...?!"

Mandje, një njeri i pashpirt e kishte kapur prej fytit të Dërguarin. Kurse Resulullahu me një qetësi të madhe i dha këtë përgjigje:

"Po, unë i kam thënë të gjitha këto!"

Në këtë çast mbërriti Ebu Bekri (r.a.), i cili i largoi ata njerëz mosbesimtarë, duke u thënë:

"-A do ta vrisni ju këtë njeri, sepse tha: "Zoti im është Allahu?!"

Një ditë Fatimja (r.a.), shikoi politeistët që ishin mbledhur në mesxhidin Haram dhe po thurnin plane për vrasjen e të atit. U kthye në shtëpi me sy të përplotur dhe ia tregoi ngjarjen të atit.

Ajo është nëna e ymetit, nëna e imamëve... Ajo është përgjigjja e të gjitha fyerjeve që iu bënë Resulullahut (jobesimtarët i thoshin Atij që ishte: ebter: fatprerë). Siç thuhet edhe në Kuran:

"Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira, andaj, falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban! Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është fatprerë."

Ajo ishte një dhuratë e Allahut. Premtimi i Zotit të gjithësisë u realizua me ardhjen në jetë të Fatimes... Me dritën e saj u ndriçua e gjithë bota dhe me anë të saj Allahu (xh.sh.), na tregoi vendin e lartë të gruas në shoqëri... Brezi i pastër i Pejgamberit tonë buron nga trupi i asaj gruaje të ndritur.

Në momentin kur ishte afruar koha që Pejgamberi (a.s.), do të largohej nga kjo botë, ajo qëndroi tek koka e babait të saj të dashur. Pejgamber i tha disa fjalë në vesh vajzës së shtrenjtë dhe Fatimja filloi të qante.

Resulullahu i bëri me shenjë të afrohej dhe i tha përsëri diçka tjetër. Pas kësaj, Fatimja pushoi së qari dhe buzëqeshi. Më vonë, kur e pyetën për arsyen e lotëve dhe të buzëqeshjes, ajo u tregoi se herën e parë Pejgamber i kishte thënë se *nuk do të shpëtonte dot nga sëmundja që e kishte zënë dhe se do të vdiste*; prandaj ajo nuk kishte mundur t'i frenonte lotët. Herën e dytë që Ai e kishte thirrur, i kishte thënë se *ajo do të ishte e para nga familja që do të bashkohej me të*, prandaj ajo kishte buzëqeshur.

Fatimja ishte vajza e dashur që shpeshherë kishte mëshirën e një nëne të dhembshur ndaj babait të saj, të Dërguarit të fundit... Ajo ishte dëshmitare e shumë prej vuajtjeve të të Dërguarit. Fatimja ishte e lumtur që do të vdiste shumë shpejt pas babit të vet të shtrenjtë, pa marrë parasysh asgjë. A ka gjë më të shtrenjtë se lotët që derdhi ajo për babain e vet të mëshirshëm dhe se dashuria e pafund që kishte ajo për të?!

Fjala e fundit: Fatimja i dhuroi lotët e saj Resulullahut, po ne çfarë po i dhurojmë Atij?!

Nesliban Nur Turk

Mbylli sytë, mos të të shikojë kush

Allahu të ruajtë ty nga shikimi i keq, nga syri i keq.

Mbylli sytë zemër, mos të të shikojë kush!

Kishte kaluar mesnata. Çdokush i mbylli sytë. Trupat ranë në gjumë, kurse shpirtrat nisën udhëtimin e tyre. Pikërisht kjo është koha më e mirë për të shkruar. Le të më bëjë shoqëri një kafe e ngrohtë! Gjumi të ikën vetëm kur je duke qëndruar me një njeri të dashur. Duke qenë se gjumi është larguar, le të hedhim shikimin tonë larg. Ku? Në horizont... Le të shikojmë larg shumë larg...

Atëherë, nëse tani më do mua, më bëj shoqëri. Në këtë kohë kur shumica e njerëzve po flenë, ti mos i mbyll sytë, por shiko... Ilaci i njeriut të dashuruar është fytyra e të dashurit. Por nga ana tjetër, unë jam xheloze, mbylli sytë, mos të të shikojë kush!

* * *

Mendojnë se fytyra është e përbërë vetëm prej dy syve, nga buzët dhe faqet. Në të vërtetë, të

gjitha këto nuk janë asgjë tjetër veçse lëkura e saj... Ajo që e bën një fytyrë të bukur, është përmbajtja e saj. Kush dëshiron të kuptojë e kupton këtë gjë, të tjerët le të vazhdojnë me mendimet e tyre të gabuara.

Mendojnë se mund ta vështrosh një fytyrë vetëm kur e ke përballë. Por nuk është ashtu! Ata nuk e dinë se një fytyrë mund të shikohet plot ëndje edhe kur je shumë larg.

Tani, nëse unë jam me vlerë për ty, mos i mbyll sytë!.. Edhe nëse do t'i ulësh perdet, mos e mbyll krejtësisht dritaren! Vështro, sepse shërimi i të dashuruarit vjen duke shikuar rrugën që i dashuri merr. I dashuri është shërim, mjafton që i dashuruarit të mund të thotë: "Kam mbetur duke shikuar rrugën nga kalon ti". Nga ana tjetër, kam frikë, prandaj mbylli sytë, mos të të shikojnë të tjerët!"

* * *

Mbase do të pyesësh se pse duhet t'i hapësh sytë? E çfarë ka për të mos e kuptuar zemër?! Do të hapësh sytë e tu për të shikuar Zotin! Do t'i hapësh sytë për të shikuar drejt hallallit, dritës, diellit, së bukurës!

Mjafton që ti të dorëzohesh, sepse i Plotfuqishmi do të të ndihmojë... Nëse nuk e ke kuptuar atë që sapo të thashë, kujto gjërat që bëri Ibrahim (a.s.), kur ishte duke bërë kurban të birin. Bëhu e fuqishme! Bëhu guximtare! Edhe nëse ke vështirësi për të ecur në rrugën e drejtë, kurrë mos dysho, por ec përpara me gëzim dhe me shpresë!

Tani hajde të shikojmë rrugën e miqve të Zotit dhe vështirësitë që ata kanë jetuar! Vështro... Shiko se si nuk kanë frikë nga vështirësitë! Kupto vështirësitë që kanë hasur ata që kanë dashur. Ti duhet ta ngjasosh shikimin me ilaçin. Por nga ana tjetër, nuk duroj dot; mbylli sytë, mos të të shikojë kush!"

* * *

Kur përmes xhamit të shikojë fytyrën time, unë do të lumturohem. Hajde mësoje nga ai se si duhet të shikosh. Shiko në një mënyrë të tillë që të ringjallet shpirti im i vdekur.... Mbushe botën time me një shikim të thellë dhe të mprehtë! Nuk dua të më shikojë askush tjetër përveç teje!

Sytë e tu që po më shikonin ishin të zinj, nuk

e di se çfarë ngjyrë kanë kur shikojnë dikë tjetër. Mos vallë kjo ngjyrë e zezë është vetëm për mua, për egon time... Nuk ka rëndësi se cila është përgjigja e kësaj pyetjeje, dua vetëm të më shikosh ashtu! Mos e ruaj shikimin prej meje! Më vështro mua aq gjatë, sa ta marr brenda vetes atë shikim. Mos lejo që të humbas shpresën!

Kur unë të jem perde për sytë e tu, nga cila anë të shikosh do të jem unë qendra e shikimit tënd. Atëherë ti mund ta hapësh ose ta mbyllësh perden, nuk ka rëndësi; mjafton që të vazhdosh të më shikosh mua... Nga ana tjetër, kam frikë prandaj: Mbylli sytë, mos të të shikojë kush!

* * *

Një ditë përfundon, një ditë tjetër lind. Çfarë është kjo dashuri që ekziston mes diellit dhe hënës? Më duket sikur ne jemi toka, kurse mbas xhamit ndodhet dielli i të gjithë diejve: më i Dashuri i Allahut, Profeti (a.s.) ! Atëherë edhe ne duhet të sillemi rreth Tij siç sillen fluturat rreth dritës! Sa të lumtur duhet të jemi që është Ai burimi ynë i dritës. Ne duhet të ecim në rrugën që të çon drejt ndriçimit! Toka sillet gjithmonë rreth vetes, por Allahu e ka bërë të tillë këtë rrotullim, që të jetë i qetë dhe askush mos ta vërë re. Në qiellin rreth saj ndodhin furtuna, digjen zjarre; por ajo kurrë nuk resht së bëri detyrën e saj!..

Hajde dhe mos i mbyll sytë! Shikoje se sa mrekulli ka kjo botë. Sa begati ka, që do të të bëjnë



të buzëqeshësh. Unë nuk dua që të lodhen sytë e tu, le të qetësohen pak... Mbylli sytë, mos të të shohë kush!

* * *

Në të vërtetë, u deshën shumë vite që të zbulohet e vërteta, shiko dhe pak! Le të hapen sytë edhe pak, tani që ke filluar të gëzohesh. Ka shumë fëmijë, të cilëve u duhet treguar rruga e drejtë. Kemi histori të cilat do t'ua tregojmë atyre...

Mos i mbylli sytë, sepse kemi shumë punë! Shiko hënën e plotë se si po na buzëqesh neve.

"Mos u shqetësoni, edhe pse jeni larg, ju po më shikoni mua së bashku, sa e bukur është kjo gjë." - thotë ajo.

Ajo na këshillon të jemi të durueshëm. Sigurisht që një ditë errësira do të zhduket për t'ia lënë vendin dritës.

Mos i mbylli sytë! Mos i mbylli sytë, sepse kur të vijë ajo ditë, ne do të kemi një shtëpi të bardhë të mbushur me lule shumëngjyrëshe. Jo! Të gjitha këto do t'i kemi para se të vdesim. Do ta shijojmë këtu këtë kënaqësi. Në fakt, nuk e di nëse do të mund ta shijojmë dot këtë në botën tjetër... Në fakt, ajo që quajmë bota tjetër, a nuk është marrja e rezultateve të gjërave që bëjmë në këtë botë? A nuk është kjo arsyeja pse jetojmë në këtë botë para se të udhëtojmë për në botën tjetër? Edhe nëse nuk vdesim dot, do të bëjmë sikur kemi vdekur! Nëse nuk fshihemi nga armiqtë

tanë duke bërë sikur kemi vdekur, si do të mund të futemi në varr?

Pa ndodhur kjo mos i mbylli sytë! Mos i mbylli sytë para se të vdesësh! Mos ul askënd, sepse ti e di se disa njerëz të tillë janë të zhytur në detin e mirënjohjes ndaj Zotit.

Mos i mbylli sytë! Në fakt unë kam filluar të kem frikë nga thurja e ëndrrave si pasojë e shumë rasteve kur jam zhgënjyer prej tyre. Më jep gëzim dhe forcë mua! Duhet të kuptosh se unë kam nevojë për një shikim tëndin! Por nga ana tjetër, kam frikë se dikush tjetër përfiton nga kjo, mbylli sytë mos të të shikojë kush!

* * *

Dashuria nuk mbaron kurrë. Ajo ndryshon, largohet, afrohet; por nuk vdes! Sillet e sillet, por vjen përsëri në zemër, vjen tek i dashuri! Uroj që dashuria jote të jetë për Allahun, kurse mëshira për hir të Allahut të jetë për mua dhe gjithë njerëzimin. Më duaj mua për hir të Allahut!

Nuk dua! Mos u verbo! Nëse unë bëj një gabim, ti mos i mbylli sytë! Më duaj mua me gjithë gabimet e mia. Zëvendësoje dobësinë time me forcën tënde!

Më përmend në duatë e tua, që ky shpirt të mos ndjej më mall për ty. Unë e di se tani që po i lutesh Zotit, sytë të mbushen me lot dhe zbukurohesh. Allahu të ruajtë nga shikimet e dëmshme, nga syri i keq, mbylli sytë! Mos të të shikojë kush!



Osman Nuri Topbash

NJË KËSHILLË, NJË MIJË MËSIMË...

Çdo individ ndjen nevojën për këshilla gjatë jetës së tij, pavarësisht nivelit intelektual, social apo profesional në të cilin ndodhet.

Pejgamberi (a.s.), duke e shprehur këtë realitet në hadithin: **"Feja është këshillë."** (Muslim, Iman, 95), pothuajse e deklaroi këshillën si mjetin e vetëm të shpjegimit të fesë. Për më tepër, përsëritja tri herë e kësaj porositje nga Pejgamberi (a.s.), tregon rëndësinë dhe nevojën e përsëritjes së këshillës.

Nëse një besimtar në kohën dhe vendin ku jeton nuk gjen dot njerëz të urtë e të mençur, me këshillat e të cilëve mund të orientohej dhe ndriçojë rrugën drejt së vërtetës, duhet medoemos që mësimet prej të cilave mund të përfitojë, t'i nxjerrë nga ngjarjet dhe ndodhitë historike. Ky është edhe qëllimi kryesor i përpilimit të librave me tregime mistike. Këto vepra janë shkruar për të përfituar prej njerëzve të urtë, të cilët kanë jetuar në kohë dhe vende të ndryshme.

Sundimi i katër halifëve të drejtë me gjithë gjashtë muajt e sundimit të Hasanit (r.a.), pati një jetëgjatësi totale prej tridhjetë vjetësh. Kjo periudhë e kalifatit, ngaqë u mbujt me begatinë shpirtërore të Pejgamberit (a.s.), u përmbush në mënyrë të përsosur. Kurse në periudhën mbas kalifëve të drejtë, ashtu siç kishte paralajmëruar Pejgamberi (a.s.), do të sundonte despotizmi dhe, për këtë arsye, periudha mbas kalifëve të drejtë është quajtur "kalifat formal". Të parët

e kalifatit formal janë kalifët e dinastisë umejade.

Megjithëse dinastia Umejade u kontestua në mënyrë masive nga myslimanët për shkak të qëndrimit të pahijshëm që mbajti ndaj Ehli Bejt, në të pati edhe personalitete të shquara si Omer ibn Abdulazizi, i cili brenda një kohe mjaft të shkurtër në të cilën qëndroi në pushtet fitoi admirimin e të gjithë myslimanëve përmes përmbushjes me përpikëri të detyrave dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Përveç Omer ibn Abdulazizit, kalifët e dinastisë umejade ngaqë islamizimin e popullsisë e perceptuan edhe si arabizim të saj, u përballën me reagime dhe antipati të thella nga ana e popujve të sapokonvertuar në Islam. Kjo bëri që jetëgjatësia e dinastisë umejade të mos i kalonte 92 vjetët.

Paraardhësi i Omer ibn Abdulazizit ishte kalifi Sulejman ibn Abdulmelik. Dialogu i këtij të fundit, realizuar me një nga personalitetet e shquara të brezit të tabiinëve, siç ishte Ebu Hazimi, ka zënë një vend të veçantë në literaturën islame të urtësisë për shkak të këshillave të vyera që përmban.

Sulejman ibn Abdulmelik niset nga Meka për në Medine, për të qëndruar disa ditë në qytetin e Pejgamberit (a.s.). Kur arriti në Medine pyeti të pranishmit nëse jetonte ndonjë që kishte marrë mësim dhe ishte edukuar nën kujdesin

e sahabëve të Pejgamberit (a.s.). Të pranishmit e informuan për dietarin e famshëm Ebu Hazim. Kalifi menjëherë dërgoi një person për ta sjellë pranë tij. Kur mbërriti, midis tij dhe Kalifit u zhvillua ky dialog:

Kalifi:

- Unë erdha në Medinë si kalif, përse kjo mungesë respekti dhe mosinteresimi nga ana juaj? Përse mbani distancë nga unë?

Ebu Hazim:

- O Prijësi i besimtarëve, çfarë marrëdhënieje mund të kem unë me ju?

Kalifi:

- Ndërsa paria e Medinës erdhi të më takojë, ti përse nuk erdhe?

Ebu Hazim:

- O Prijësi i besimtarëve! Deri më sot as ti nuk më njihje mua dhe as unë ty. Në këtë mënyrë, si mund të presësh një interesim të veçantë nga ana ime?

Kalifi u kthye nga Muhamed ibn Shihab ez-Zuhri, duke i thënë: "Ky njeri ka të drejtë, unë bëra gabim." Dhe duke ndjerë nevojën për këshillat e këtij njeriu të urtë, e pyeti:

- Ebu Hazim! Si ka mundësi që ne e urrejmë vdekjen?

Ebu Hazimi:

- Sepse ju keni rënë pre e dëshirave epshore dhe pasioneve, keni ndërtuar dynjanë duke rrënuar ahiretin. Për këtë arsye, urreni të shkoni nga një vend i mirëndërtuar në një vend të rrënuar.

Kalifi:

- Të vërtetën the, o Ebu Hazim! Si do të dalin para Allahut njerëzit në Ditën e Gjykimit?

Ebu Hazim:

- Vepërmirët do të dalin të lumtur e të qetë si personat që kthehen në familjen e tyre pas një kurbeti të gjatë. Kurse ata që kanë qenë robër të epsheve të tyre do të dalin para Allahut si skllavi që kapet duke u arratisur dhe sillet para pronarit. Kalifi përballë kësaj përgjigjeje nuk mundi të

duronte dhe filloi të qante me dënësë. Dhe duke shprehur keqardhjen, tha:

- Ah, sikur ta dija si do ta takoj Allahun!

Ebu Hazimi:

- Atëherë rregulloji veprat sipas Librit të Allahut dhe Sunetit të Pejgamberit (a.s.).

Kalifi:

- Më trego çfarë duhet të bëj për të rregulluar pozitën time para Allahut.

Ebu Hazimi lexoi ajetin: **"Pa dyshim, të mirët janë në xhenet, kurse mëkatarët me siguri në xhehenem."** (Infitar, 13-14)

Kalifi:

- Po mëshira e Allahut, ku është?

Këtë herë Ebu Hazimi lexoi ajetin: **"Vërtet, mëshira e Allahut është afër punëmirëve."** (Araf, 56)

Më pas dialogu vazhdoi kështu:

Kalifi:

- Cilët janë robërit më të mirë të Allahut?

Ebu Hazimi:

- Robërit më të mirë tek Allahu janë mëshiruesit, bujarët, modestët, të mençurit që nxjerrin mësimet dhe njerëzit që janë në shërbim të njerëzimit.

- Cila është vepra më e vyer?

- Qëndrimi larg haramëve dhe kryerja e detyrimeve me kënaqësi, nderim dhe përpulje.

- Cila është lutja më e pranueshme?

- Lutja që bën për personin që ju ka bërë një të mirë.

- Cila sadaka është më e çmuar?

- Lëmosha e personit që është nevojtar dhe që nuk shoqërohet me përmendje.

- Cila është fjala më e drejtë?

- Thënia e së vërtetës personit që ke frikë ose personit prej të cilit shpreson të përfitosh diçka.

- Cili është besimtari më i mençur?

- Besimtari i përkushtuar në bindjen ndaj Allahut dhe që është shembull për njerëzit në këtë çështje.



- Cili është personi më mendjelehtë?

- Personi që anon nga dynjaja, duke harruar ahiretin. Ai i cili, duke ndjekur dëshirat e shokut të vet rrënoi ahiretin për dynjanë e tjetërkujt.

- Të gjitha çfarë the janë më se të sakta, po për gjendjen tonë çfarë mendon?

- O prijësi i besimtarëve, më lejoni të mos i përgjigjem kësaj pyetjeje.

- Jo! Konsideroje si këshillë për mua këtë përgjigje.

Ebu Hazimi:

- O sundues i besimtarëve! Baballarët e tu i kanë shtypur njerëzit me shpatë dhe këtë mbretëri e morën me forcë pa u këshilluar me myslimanët dhe pa dëshirën e tyre, duke vrarë shumë prej tyre; tani ata janë larguar nga kjo botë, ah sikur t'i dëgjoje se ç'thanë e ç'iu tha atyre (para Zotit).

Një i pranishëm, në formë qortimi i tha:

- Këtu gabove, o Ebu Hazim!

Ebu Hazimi:

- Jo, këtu po gabon ti, sepse Allahu i ka urdhëruar dijetarët të thonë të vërtetën pa pasur frikë nga askush dhe të mos e fshehin atë.

Sulejmani:

- Si mund të përmirësohemi?

Ebu Hazimi:

- Braktisni padrejtësitë dhe dhunën, silluni mirë me njerëzit dhe gjykoni me drejtësi midis tyre, atëherë mund të përmirësoheni.

- Si mund ta realizojmë këtë gjë?

- Fitojeni pasurinë në mënyrë të drejtë, shpenzoni pasurinë për ata që kanë nevojë.

Sulejmani:

- A do të na shoqërosh o Ebu Hazim, që të marrësh nga ne e të marrim nga ti?

Ebu Hazimi:

- Allahu më ruajtë prej kësaj!

Pse pyeti kalifi?

- Kam frikë se do të anoj pak nga ju, sepse ju jeni nën sundimin e dëshirave, nëse anoj nga ju, Allahu do të më bëjë të shijoj dobësinë e jetës dhe të vdekjes.

Sulejmani:

- Më thuaj, për çfarë ke nevojë?

Ebu Hazimi:

- Më shpëto nga zjarri dhe më bëj të mundur të hyj në xhenet.

Sulejmani:

- Nuk kam mundësi për një gjë të tillë.

Ebu Hazimi:

- Edhe unë nuk kam nevojë për gjë tjetër.

Sulejmani:

- Lutu për mua atëherë.

- O Zot! Nëse Sulejmani është miku Yt, jepi atij mirësi dhe begati në këtë botë dhe botën tjetër. Nëse është mëkatar, ndihmoje të kthehet në rrugën prej së cilës Ti je i kënaqur.

- Kaq?

- Nëse e meriton këtë lutje, unë me të vërtetë kam bërë një lutje shumë të vlefshme, nëse nuk e meriton apo nuk ke dëshirë të ecësh në rrugën e drejtë, atëherë kjo lutje i ngjan hedhjes së shigjetës me një hark që nuk ka fill, pra nuk shërben për asgjë.

- Çfarë më këshillon tjetër?

- Do të të jap një këshillë të urtë: Adhuroje Allahun me respekt dhe kujdes, tregohu i kujdesshëm në urdhëresat dhe ndalesat e Tij, në mënyrë që Allahu të të gjejë gjithmonë aty ku të ka urdhëruar e jo ku të ka ndaluar.

Sapo Ebu Hazimi doli, Kalifi i dërgoi njëqind dinarë dhe një letër ku i shkruante që t'i shpenzonte, sepse do t'i jepte edhe më shumë.

Por Ebu Hazimi nuk i pranoi dhe së bashku me dinarët i dërgoi edhe një letër, ku i shkruante:

- O prijësi i besimtarëve! Më vjen shumë keq që nuk paske përfutur asnjë dobi nga këshillat dhe përgjigjet. Si mund t'ia lejoj vetes ato që t'i ndalova ty? Unë nuk të këshillova kundrejt shpërblimit, në lidhje me këtë dua të tregoj historinë e Musait (a.s.), me dy vajzat e Shuajbit (a.s.).

Kur Musai (a.s.), arriti te burimi i Medjenit, gjeti aty shumë njerëz duke u dhënë ujë bagëtive. Përveç tyre, ai vuri re edhe dy vajza që po mbanin kafshët e veta. Ai u tha: "Si e keni hallin ju?" Ato thanë: "Ne nuk mund t'u japim ujë bagëtive tona pa u larguar barinjtë. Babai ynë është shu-

më i moshuar". Musai (a.s.), pasi i ndihmoi t'u jepnin ujë bagëtive, u ul nën një hije aty pranë dhe iu lut Zotit: **"Zoti im, unë jam nevojtar për çdo mirësi Tënden."** (Kassas, 23-26)

Musai (a.s.), po lutej ndërsa ishte i lodhur dhe i uritur nga udhëtimi i gjatë, në të njëjtën kohë ishte i frikësuar nga rreziku që mund t'i vinte prej armiqve. Por Ai me gjithë atë gjendje të rënduar, strehimin dhe qetësinë e gjeti vetëm tek Allahu, duke injoruar çdo lloj ndihme tjetër.

Vajzat e kuptuan menjëherë gjendjen e Musait (a.s.) dhe sapo arritën në shtëpi, i treguan babait për të panjohurin që i ndihmoi.

Shuajbi (a.s.), i tha njëres prej vajzave: "Shko thirrë të na nderojë në shtëpi, sepse duhet të jetë i uritur."

Vajza shkoi në vendin ku ishte Musai (a.s.) dhe gjithë respekt dhe nderim i tha:

Babai ju fton në shtëpi, që t'ju shpërblejë për ndihmën që na bëtë.

Musait (a.s.), i erdhi rëndë përmendja e shpërblimit, por nuk gjeti zgjidhje tjetër përveçse të ndiqte vajzën për në shtëpinë e Shuajbit (a.s.).

Ndërsa vajza ecte para Musait (a.s.), era që frynte i ngjiste rrobat pas trupit, duke i shfaqur linjat. Musai (a.s.), përpiquej të mbante larg shikimin, duke kthyer kokën herë djathtas herë majtas. Më në fund, i tha:

- Ecni ju mbas meje dhe më oriento me fjalë cilën rrugë duhet të ndjek.

Kur Musai (a.s.), mbërriti te shtëpia e Shuajbit, e gjeti darkën të shtruar. Shuajbi (a.s.), e ftoi të ulej për të ngrënë, por Musai (a.s.), refuzoi të ulej.

Shuajbi (a.s.):

- Përse nuk uleni apo nuk jeni i uritur?

I uritur jam, por kam frikë se kjo bukë është si shpërblim i ndihmës që u bëra vajzave. Ne rrjedhim nga një familje, e cila çdo bamirësi e bën vetëm për hir të Allahut.

Shuajbi u drejtua nga ai dhe i tha: "Jo, nuk është ashtu siç mendon ti, por mikpritja dhe përcjellja bujare e mysafirëve është traditë në familjen tonë."

Pas këtyre fjalëve të singerta dhe të përzemërta të Shuajbit, Musai (a.s.), u ul për të ngrënë.

Ebu Hazimi, pasi i tregoi historinë e Musait (a.s.), e vazhdoi kështu letëren drejtuar Kalifit:

"Nëse këto njëqind dinarë janë si shpërblim i këshillave të mia për ty, atëherë mishi i ngordhur, mishi i derrit dhe gjaku, të cilat janë të lejuara në raste të veçanta, janë më të mirë se këto njëqind dinarë. Nëse mendon se këto janë e drejta ime nga thesari i shtetit, atëherë ka shumë të tjerë para meje që kanë të drejtë të përfitojnë nga thesari i shtetit. Vetëm nëse ke bërë një ndarje të drejtë, atëherë nuk ka problem, përndryshe unë nuk kam nevojë për dinarë. (Darimi, Mukaddime, 56/653; Ebu nuajm, Hilje, III, 234-236)

Kalifi Sulejman ishte një sundimtar i drejtë dhe i arsyeshëm. Por siç e theksoi edhe Ebu Hazimi, në një masë të vogël sundohej nga dëshirat dhe kënaqësitë e çastit. Por sa vetë në botë kanë arritur të shpëtojnë në mënyrë absolute nga kthetrat e nefsit?!

Edhe ne ashtu si Kalifi Sulejman, dikush më pak dikush më shumë, jemi nën sundimin e nefsit. Këto këshilla të Ebu Hazimit drejtuar Kalifes duhet t'i vlerësojmë si këshilla drejtuar edhe ndaj nesh, në mënyrë që ta kemi më të lehtë për të mposhtur egon dhe rregulluar veprat sipas Kuranit dhe Traditës Profetike.

Një mik i Zotit thotë: "Një bletë, për të mbushur një hoje me mjaltë mbledh nektar prej një mijë lulësh."

Ashtu si bleta që shëtiti mbi një mijë lule për të mbledhur nektarin që të prodhojë më pas mjaltin edhe ne si besimtarë duhet të marrim mësim nga jeta e Pejgamberit (a.s.) dhe miqve të dashur të Allahut, për t'i pasqyruar në çdo moment të jetës sonë, në mënyrë që t'i ofrojmë gjithë njerëzimit mirësjelljen dhe ëmbëlsinë e Islamit.

O Zot, na mundëso të përfitojmë në jetën tonë copëza nga morali dhe personaliteti shembullor i Hazreti Muhamedit (a.s.)!.. Na ndihmo të përfitojmë nga mënyra e edukimit, mësimdhënies dhe të gjitha virtytet e larta të Tij!.. Na zbukuro me moralin e Tij të rrallë dhe na mundëso që përmes pasqyrimit të moralit të Tij të bëhemi shkak për udhëzimin e shumë njerëzve të tjerë!

Amin...!

Privatësia

Aisbegyl Ballta

është mëshirë



Privatësia është një dhuratë që na është ofruar nga feja. Jonë për të jetuar këtë jetë në mënyrë të matur... Ai njeri që e kupton këtë mrekulli dhe që mbështetet në të është i fituar, kurse ai që i del kundër është në humbje.

Kufiri i privatësisë që duhet ruajtur mes një burri dhe një gruaje është një e mirë që vjen nga Allahu... Të ruash privatësinë është qytetari... Pa këtë jeta jonë nuk ka kuptim; e tillë ajo i ngjan një tabloje të pakuptimtë të varur në mur... Respekti që tregon secila gjini për gjininë tjetër është një nga treguesit më të qartë të qytetarisë së një shoqërie.

Në një shoqëri të shëndetshme është e rëndësishme ruajtja e marrëdhënieve njerëzore...

Ligji i krijimit të çiftit... Gruaja dhe burri janë krijuar në bazë të këtij ligji... Tërheqja mes të dyve është forca më e madhe tërheqëse që ekziston.

Çdo gjë tërheqëse është me vlerë të lartë dhe si e tillë duhet mbrojtur.

Mahremjeti në një kuptim shpreh gjërat e ndaluara midis gruas dhe burrit...

Gjërat e ndaluara në Islam janë ose shumë të rëndësishme ose krejt të pa vlera. Mungesa e respektit ndaj Qabes është e ndaluar, kjo vjen nga vlera e madhe që ka Qabja... Alkooli është haram sepse pija është e dëmshme; ose mund ta shpjegojmë në këtë mënyrë: pija e shndërron mendjen e lartë dhe të nderuar të njeriut në një dobësi të dëmshme...

Privatësia është një sekret që e rrit vlerën e asaj që është e vlefshme... Në çdo dashuri ka një sekret. Çdo sekret është i fshehur pas një fytyre. Pjesa më e madhe e njerëzve gënjehen nga kjo fytyrë. Iblisi kur shikoi fytyrën e Ademit (a.s.) tha:

"- Unë nuk i përulëm atij, unë jam më i lartë se ai!"

Ai zgjodhi rebelimin para nënshtrimit. Njerëzit që mbesin në kurthin e shejtanit i gjykoj-

në fytyrat me anë të egos së tyre, jo me ndihmën e zemrës!..

Edhe privatësia është një provim i nënshtimit. Fytyra e saj në këtë botë duket e shëmtuar, e zymtë dhe e mërzitshme, por në të vërtetë brenda saj ka mëshirë, qetësi dhe lumturi.

Islami është mëshirë. Kjo fe është një bekim që i jep edhe gruas edhe burrit të drejtat përkatëse. Privatësia është një dhuratë që na është ofruar nga feja jonë për të jetuar këtë jetë në mënyrë të matur... Ai njeri që e kupton këtë mrekulli dhe që mbështetet në të është i fituar, kurse ai që i del kundër është në humbje.

Privatësia është çelësi i sigurisë. Ajo të ruan nga zjarri i xhehenemit. Shoqëria e ditëve të sotme nuk e zbaton këtë rregull dhe prandaj është e dënuar të jetë gjithmonë në lojë me zjarrin. Bashkësia njerëzore digjet nga shumë arsye. Televizioni është një nga këto arsye, interneti është një tjetër... Një arsye tjetër shumë e rëndë që ka shumë ndikim është edhe rënia e nivelit të arsimit... Jeta që jetohet larg islamit është gjithmonë një vend zjarri...

Nëse në një rrugë ka rreziqe dhe nëse fundi i asaj rruge mund të jetë një greminë atëherë Islami e ndalon hyrjen në atë rrugë. Feja islame e ndalon ecjen në rrugën që të çon në haram.

Pse shikimi i dytë është haram? Sepse nëse ti nuk e edukon shikimin me rregullat e Allahut atëherë edhe ti mund të bëhesh një Zylejha! A e din se kush ishte Zylejhaja? Ajo ishte një grua që e dashuroi Jusufin (a.s.) e mahnitur nga bukuria e tij. Ajo ishte një grua e pasur që hante në enë prej ari dhe ecte në tapete prej pambuku... Jusufi (a.s.) ishte si një pasqyrim i bukurisë së Zotit, hijeshia e tij përmendej nga çdokush... Edhe Zylejhaja kishte një bukuri të lavdëruar... Ajo ishte gruaja e sundimtarit të Egjiptit... Ajo zotëronte çdo gjë por i mungonte edukata, morali dhe modestia që duhet të ketë një grua besimtare.

Një ditë Zylejhaja e gjeti vetëm në dhomë Jusufin dhe vrapoi pranë tij. u mundua ta joshte atë. Sikur çdo banor tjetër i Egjiptit të ndodhej në atë gjendje do t'i përgjigjej ftesës së Zylejhasë së bukur; por Jusufi u largua sepse u kujtua për Atë që i kishte dhuruar këtë bukuri marramendëse Zylejhasë. Ai u largua prej saj për hir të Allahut.

"- Kërkoj mbrojtje tek Allahu!"- tha ai.

Nuk e kaloi kufirin që i kishte vendosur feja e vet dhe Allahu e ruajti atë. Sikur të mos kishte vepruar ashtu nuk do të kishte mundur të shpëtonte nga

kjo tërheqje femërore.

"- Ajo e dëshiroi atë; por edhe Jusufi do ta kishte dëshiruar atë, sikur të mos kishte parë provën e Zotit të vet." (Jusuf, 24)

Pejgamberi ishte i pafajshëm dhe i ruajtur nga Allahu por në fund të fundit edhe ai ishte një njeri si gjithë të tjerët. Nga harami atë e ruajti vetëm mbështetja në Zot... Kush nuk i mbështetet Zotit zhytet në ujëra të ndotura...

Familja është diçka e shenjtë... Ajo është bërthama e shoqërisë. Familja i ka rrënjët në xhenet kurse degët në pafundësi... Fshehtësia është shumë e rëndësishme për ruajtjen e familjes. Lidhjet mes pjesëtarëve të familjes janë gjithashtu të rëndësishme. Një ditë e pyetën Profetin se në cilat çështje duhet bërë kujdes kur jeton me nënën duke i thënë:

"- Kur shkoj pranë nënës a duhet të kërkoj leje?"

I Dërguari tha:

"- Po!"

"- Por unë jetoj në të njëjtën shtëpi me të."

Pejgamberi i nderuar i tha:

"- Kërko leje për të hyrë në dhomën ku qëndron ajo."

Pas kësaj ai njeri pyeti:

"- Por ajo më shërben mua."

Pejgamberi i dha këtë përgjigje:

"- Kërko leje nga nënë jote. A je dakord që ti ta shikosh të zbuluar atë?"

Personi që po e pyeste i tha:

"- Jo!"

Pas kësaj Pejgamberi (a.s.) përsëriti fjalinë:

"- Kërko leje prej saj!"

Edhe pse nëna është krijesa më e afërt e njeriut, me të është vendosur një kufi. Mos respektimi i këtyre kufijve mund t'i hap rrugë problemeve të mëdha në familje dhe bën që njeriu të hyjë në rrugë pa kthim.

Mbyllja e syve para të vërtetës njerëzore nuk është zgjidhje. Në Islam ekziston ajo që quhet: realiteti njerëzor. Pikërisht kjo është veçantia e fesë Islame. Ajo e shikon realitetin njerëzor dhe në bazë të këtij realiteti vendos rregulla, emri i të cilave është : mahrem (fshehtësi). Fshehtësia është mëshirë; një mëshirë që ruan të gjithë njerëzit, nga më i vogli deri tek më i madhi... Sa të lumtur janë njerëzit që përfitojnë nga kjo mëshirë!..

E nisa shpirtin tim drejt qiellit

Aisbenur Uurall

Allahu (xh.sh.), gjatë gjithë kohës na shfaq neve shenja të bukurisë dhe madhështisë së Tij. Këto shenja nganjëherë janë aq të veçanta dhe të vështira për t'u kuptuar, sa jo çdokush mund t'i vërë re. Ashtu siç ka kuptim të ndryshëm bora për secilin nga ne, dikujt i kujton lojën me borë, dikujt tjetër i kujton njeriun prej bore e dikujt tjetër i sjell në mendje vetëm trafikun dhe pushimin në shkolla e në punë, ashtu edhe madhështia hyjnore manifestohet përmes formave dhe mënyrave të ndryshme.

Kjo lidhet me ndarjen e shtresave të shoqërisë në vitet e kaluara: klasa aristokrate. Ushtarake, klasa fshtare etj. Njerëz të ndryshëm kanë konceptime dhe mënyra të ndryshme të të kuptuarit.

Më kujtohet ngjarja kur Hz. Aishe kishte vështruar nga dritarja dhe kishte parë Muhamedin (a.s.), duke ecur nën një shi të bukur. Kur Ai ishte futur në shtëpi, ajo kishte vënë re se mbi të nuk kishte asnjë shenjë që tregonte se ishte lagur. E kishte kontrolluar me dorë, por përsëri nuk kishte gjetur asnjë gjë... Qafa e Tij ishte më e bukur se e drerit dhe sa bukur dukej dora e Aishes (r.a.), mbi atë qafë hyjnore... Por qafa e Tij nuk ishte e lagur... I dashuri i Allahut e pyet i buzëqeshur:

"Çfarë po kërkon, o drita e syve të mi?"

...

"Ai që ti ke parë ka qenë shi hyjnor."

Ky është shi që freskon zemrën në një ditë, kur zgjohesh në mëngjes dhe shikon bardhësi, çdo anë është e mbuluar nga një vel i bardhë, ndjen një pastërti në shpirt, ndjen qetësi. Në shpirtin tënd hapen dritaret. Ngrihen perdet, që të kishin mbuluar sytë deri atë ditë... Në veshë të shungullon ajeti: "Vraponi

drejt Allahut, vraponi drejt Allahut!.."

Dashuria është e tillë!.. Dashuria e disa njerëzve mbaron një ditë, kurse ata që me të vërtetë e kuptojnë rëndësinë e dashurisë, vrapojnë drejt saj. Veshët e të dashuruarve dëgjojnë vetëm thirrjen e dashurisë... Kemi dëgjuar edhe për Hz. Ibrahimin (a.s.), të cilin, kur po ndërtonte Qaben, Allahu e kishte urdhëruar :

"Thirri ti robërit e mi!... Thirri ata nga mali Arafat. Le të kenë fatin të vijnë në Qabe të gjithë ata që do ta dëgjojnë thirrjen tënde deri në Ditën e Kijametit!.."

Një thirrje që mposht rrjedhjen e kohës. Ajo thirrje nuk dëgjohej dot prej trupave tanë të thjeshtë, por nga shpirtat tanë. Davud Kajseri ka të drejtë, kur thotë:

"Koha është vetëm një çast që kalon pa u ndier."

Shoqëria jonë ka një rregull të saj. Nëse dëshiron të jesh njëri nga ne, duhet të ndjekësh rregullat tona, duhet të bëhesh si ne. Pse të jetojmë të vetmuar në male e kodra, kur kemi shumë njerëz rreth nesh që kanë nevojë për t'i ndihmuar, për t'u treguar rrugën e drejtë... A nuk duhet të vëmë në përdorim dijet që kemi marrë? A nuk duhet të ndalojmë të keqen dhe të urdhërojmë të mirën?! A dëshirojmë njerëzit udhëzim?

Le të mendojmë se jemi një shkollë? Ne jemi një shkollë e veçantë që pranon nxënës në çdo moment, në çdo ditë të vitit. Pse nuk aplikon çdo njeri për t'u bërë pjesëtar i kësaj shkolle?

Shkollat i bëjnë të ditura zgjedhjet e tyre. I qar-

kullojnë të dhënat me anë të shtypit dhe internetit. Sigurisht që nuk është e drejtë të bëhen zgjedhje pa i lajmëruar njerëzit më përpara. Njerëzit që nuk lexojnë gazeta, që nuk shikojnë televizion dhe nuk e përdorin internetin nuk i shohin gjërat që ka bërë të ditur shkolla jonë. Por ne i bëjmë lajmërimet në një mënyrë të tillë, që t'i shikojë çdokush. Ju mendoni se ata nuk e dëgjojnë thirrjen tonë? Ata e dëgjojnë shumë mirë thirrjen tonë. A nuk janë pesë vaktet e namazit, muaji i shenjtë i Ramazanit dhe të gjitha ditët e tjera të veçanta një thirrje? Të gjitha këto janë thirrje të veçanta, jo çdokush mund t'i kuptojë... Jo të gjithë njerëzit kanë aftësinë të kuptojnë kuptimin e gjërave që u ndodhin!..

Ata kuptojnë shumë mirë, sepse çdo gjë u flet me një gjuhë të kuptueshme. A e dini se cili është problemi? Problemi është të shkosh! Pas dëgjimit të thirrjes, vjen vajtja drejt saj. Rruga drejt saj ka ecje të gjatë, rënie, lodhje e mundime. Shumë pak njerëz kanë guximin për të marrë këtë rrugë. Shumica e njerëzve i mbyll sytë dhe vazhdon të jetojë në monotoninë e zymtë të jetës... Pakica bëhet guximtare dhe thotë:

"Nëse do të jetoj kështu, më mirë të vdes. Sepse sekreti i jetës është të vdesësh para se të vijë vdekja!"

Modestia i bën njerëzit të fitojnë përjetësinë, kurse zemra e sëmurë i çon drejt shkatërrimit. Nuk do të flas më. Mos hesht, pyet, thuaj se ku të çon kjo rrugë? Ku i çon kjo rrugë njerëzit, çfarë ka në vendin ku do të shkojnë?

"Vraponi drejt Allahut!"

Fjala e bukur është si një pemë me rrënjë të forta... Fjala është një nga treguesit më të mirë të shkollimit të një njeriu... Kurani është natyra e pasqyruar në fjalë, kurse natyra vetë është një Kuran i heshtur. Njeriu mund të kuptojë nga gjuha e të dyve... Ka një fjalë që më pëlqen shumë: "Në botë ka njerëz shumë të veçantë dhe njerëzimi me anë të tyre ndriçohet dhe lartësohet."

Secili prej nesh ka vendin e vet në botë. Të gjithë ne jemi një grimcë e së tërës. Çdo njeri flet dhe kupton një gjuhë të ndryshme. Gjuha e Kuranit është e ndryshme, ashtu siç janë të ndryshme dhe të veçanta gjuhët e letërsisë dhe të muzikës. Gjuha e ngjyrave, gjallesave, qenieve pa jetë, e luleve, e maleve është e ndryshme... Gjuha e çdo njeriu, po ashtu edhe gjuha e çdo peygamberi është e ndryshme... Gjuha e çdo epoke është e ndryshme... E ndryshme është edhe gjuha e natës dhe ajo e ditës...

Disa fjalë janë të shenjta për ne që në momentin e parë që i dëgjojmë... Disa fjalë të tjera kërkojnë një kohë shumë të gjatë për të na prekur dhe për t'u bërë pjesë e zemrës sonë... Ashtu ndodh edhe

me ezanin...

"Ka fjalë që hapin, fillojnë një luftë

Ka fjalë që i flasin një mendjeje të urtë

Ka fjalë të dobishme si ilaçi

Ka fjalë të ëmbla si mjalti."

Fjala është shumë e rëndësishme, ajo mund të kthejë një ushqim të helmuar në mjaltë të ëmbël. Allahu (xh.sh.), i jep shumë rëndësi përdorimit të fjalës dhe i edukon robërit e vet në këtë çështje.

Mësuesit tanë, miqtë tanë, prindërit tanë përdorin fjalën për të na përcjellë neve mësimet e tyre... Ne përdorim fjalët për të komunikuar me ta... Nganjëherë, një fjalë e një njeriu krejt të panjohur, një fjalë e dëgjuar në radio, një fletë kalendari ose dhe një fjalë e lexuar në një reklamë na merr dhe na çon në një botë tjetër.

Ka diçka që shumë pak vetë e dinë: unë kam një ilahi që më emocionon shumë; kur e dëgjoj atë më dridhen këmbët dhe ndihem ndryshe. E kam dëgjuar shumë vite më përpara nga një zë shumë i bukur dhe i talentuar, i kërkoja disa herë që ta përsëriste dhe nuk ma prishën dëshirën... Edhe unë dëshirova ta vazhdoja këtë tregim, duke u dhuruar edhe unë atyre disa vargje. Kjo marrje - dhënie fitoi një kuptim të veçantë.

"E nisa shpirtin tim drejt qiellit,

le të shëtisë Arshin

Përmendi të gjithë emrat sot,

që Ai të të përmendë ty...

Derdha lot nga sytë e mi,

le të njomet toka

Ku të gjej Ty, o Zoti im,

Nuk shihesh nga asnjë sy."

Ndjenja ngjante me marrjen e frymëzimit nga një shpirt, që kishte arritur yjet. Zemra ime e burgosur në këtë lëkurë që më shtrëngon, u freskua nga ajri i pastër i Arshit... Mendo se sa pak i kuptojmë ne gjërat e fshehta. Nuk arrijmë të kuptojmë sekretet që fshihen pas gjërave të ndaluara dhe kufijve të vendosur... Kjo ilahi i shpjegonte shumë mirë këto gjëra. A mund të shfaqësohemi me fjalët: "Nuk të gjej dot Ty, sepse je fshehur!" para Zotit që na ka thënë se është më afër nesh se damari i qafës...

Një mbrëmje isha duke u marrë me përgatitjen e ushqimit, nga ana tjetër po mendoja dhe për foshnjën që sapo ishte zgjuar. Ndërkohë, në radio ishte një këngë popullore që e kujtoja me mall, sepse më sillte në mend motrën time që ma kishte treguar për herë të parë. Nuk po mendoja ndonjë gjë të rëndësishme... Kisha vetëm shqetësimin që të mos më digjej fundi i kusisë së supës, të mos prisja dorën me thikën e cila ishte shumë e mprehtë dhe nuk doja të harroja vendosjen e kompostos në tavolinë.



Teksa unë po mendoja të gjitha këto, një varg i këngës më tërhoqi vëmendjen. Dora që po mbante thikën u dridh dhe thika ra në tokë, dora tjetër ishte drejtuar drejt kripës, por edhe ajo mbeti e ngrirë në ajër. Me ngadalë u mbajta pas tavolinës. M'u turbullua shikimi. Në atë moment mund të qaja me ngashërim, sikur të mos kisha frikë se do të trembja vajzën e vogël. Lotët rrodhën ngadalë... Ato depërtuan në shpirtin tim. Nuk e di nëse digjet toka kur mbi të rrjedh shiu, por shpirti im u dogj nga lotët.

"I dashur nga të vi

Të gjitha rrugët janë të zëna..."

Nga njëra anë po mendoja se për cilin bandill ishin shkruar këto vargje, nga ana tjetër m'u kujtuan vargjet : *"Vetëm për Ty kam nevojë..."*

Zjarri i shpirtit tim, që kishte qenë i fikur deri atëherë, u ndez...

Një poet ka thënë se dashuria është si të mbash një mal prej hekuri në shpinë. Në atë moment e kuptova të gjithë lodhjen që kanë të dashuruarit që përshkojnë labirintet e dashurisë.

Njerëzit ndahen në pesë grupe, sipas mënyrës që i bëjnë ballë vështirësive:

1- Njerëzit që kanë durim dhe mëshirë: Si Pejgamberi ynë (a.s.), që qante për Ibrahimin e Tij.

2- Njerëzit që kanë durim: Fudajl bin Ijaz buzëqeshte në varrimin e të birit.

3- Njerëzit kryengritës.

4- Njerëzit që qajnë për humbjet e tyre, jo nga mëshira, por nga egoizmi i tyre.

Pejgamberi ynë kishte një zemër shumë të madhe, në të cilën mund të strehonte edhe dhimbjen, kurse zemra e Fudajlit të nderuar nuk ishte akoma e së njëjtës lartësi.

Kurse tek grupi i fundit futen njerëzit të cilët nuk e pranojnë humbjen, si pasojë e egos së tyre të pangopur.

Si kanë arritur njerëzit e tjerë të ecin në rrugë të drejtë dhe t'i thonë jo egos së tyre? Si kanë arritur të ruajnë ndjenjën e mëshirës dhe të durimit?

Sa mirë që kemi fjalën e Allahut: "Kur robi im ecën drejt Meje, Unë shkoj drejt tij duke vrapuar!"

"Unë jam pranë robit Tim kur ai ka një moment dyshimi. Unë jam me të kur ai më adhuron Mua. Kur ai më adhuron mua me zemër edhe unë ia kthej me zemër, nëse më adhuron me xhemat, Unë ia kthej nga një vend më i mirë. Nëse robi im më afrohet një pëllëmbë, unë i afrohem një arshën (masa gjatësie, e barabartë me 68 cm). Kur ai më afrohet një arshën, Unë i afrohem atij një kulaç (masë që përdoret në peshkim, e barabartë me 170 cm). Nëse ai afrohet drejt meje duke ecur, Unë shkoj drejt tij duke vrapuar." (Sahih-i Myslim, 2675)

Ti vazhdon ta harxhosh dhuratën më të madhe që të është dhënë: jetën, në një mënyrë të gabuar.

Allahu përsëri të thotë: "Eja në portën Time, më kërko Mua... bëhu nga ata që kërkojnë falje!"

"Shko si peshku në drejtim të detit, që të gjesht gurë të çmuar."

Kur i Dashuri do të të pyesë ty: "Çfarë do?", përgjigju: "Të dua Ty! Unë të lutem vetëm Ty." (Mevlana)



Ndoshta më shikon dhe sytë e mi shkëlqejnë

Kjo fjali është një citim i marrë nga ditari im i mbushur me ëndrra. Kjo është fjalia më e përshtatshme për t'u përmendur nga kjo pjesë e ditarit. "Ditari im i ndoshta-ve" është i përbërë nga shumë faqe A4, të mbushura me rrëfime që ma brejnë shpirtin...

Në këtë ditar kam shkruar edhe gabimet e mia më lozonjare, të përziera me ëndrrat e mia, në fillim të të cilave, pa pasur aspak turp kam shkruar nga një "ndoshta" me një pafajësi të dukshme... Ashtu siç i mbështjellim dhuratat me letër paketimi, unë i vendosa një emër atij: "Ditari i ndoshta-ve" ... I kishte shkruar shumë faqes së parë... siç duket bukur fjon-goja rozë mbi një letër paketimi...

Për të tërhequr vëmendjen tënde, kërkoja një fjalë që mund të ishte në lartësinë tënde... E fillova ditarin tim me dashuri... Ndoshta thashë, më do mua. Ndoshta edhe pas kryengritjes sime dhe pas çdo gjëje që kam bërë, më do mua...

Gjithmonë kam menduar se jeta ime e shkujdesur dhe të qeshurat pa fund ishin shumë njerëzore... Kam menduar se fundi i fundit unë jam thjesht një njeri dhe jeta ime do ta ketë një fund, prandaj duhet ta shfrytëzoj sa më mirë...

Gjithmonë mendoja se jam e bukur dhe e re, por pas këtyre fjalëve më vinte në mendje dhe një e vërtetë: mos vallë jam duke të mërëzitur... Të paktën isha në dijeni se diçka nuk shkonte... Një diçka engjëlllore, që kishte mbetur që nga krijimi im luftonte pareshtur me gjërat e ndotura rreth meje. Ishte ajo pjesë që lejonte të kuptoja se po të mërëzisja.

Dikush më pëshpëriste: "Çdo gjë e bukur ka një fund!" ... Vetëm në këto çaste pesimizmi më vinte në mend bota e përtejme. Nuk mbaron, nuk mund të mbarojë... Kemi dhe botën tjetër, xhenetin e premtuar; për më tepër që kjo bota tjetër është e pafundme. Por unë jetoja në këtë botë me qëllimin e vetëm për t'u dëfryer, nuk doja të humbisja asnjë gjë. Kjo ishte një nga shenjat e moralit tim mëkatar.

Një ditë u lodha nga këto role teatrale që po luaja

dhe vendosa t'ia nis nga fillimi... Mendova se mbase mund të më duash... Kush e di?

Ishte diçka që kisha lexuar për ty, që më bëri të vazhdoja të shpresoja; thuhej se mëshira jote ishte aq e madhe, sa falje çdokënd, edhe ata si unë. Një frenim i papritur i shoferit të autobusit më bëri të kujtoja se vdekja mund të ishte dhe krejt e papritur e atëherë më erdhi në mendje mëshira jote për të falur ata që kishin bërë gabime.

Një... Dy... Tre... Nuk e di se sa herë kam të drejtë... Nuk e di as sa herë do të vijë në mendje kjo gjë apo sa herë do të më bëhet ftesë për të shkruar në mëkat ...

Ndërsa po shkruaj këto rreshta në ditar, brenda zemrës sime diçka ndodh... Mos ka ardhur pranvera? Ndjej një erë të mirë...

Le të vijmë tek tema kryesore... Shtova një 'ndoshta' pranë shpresës se ti do të më doje mua dhe kërkoja të përfitoj nga mëshira jote... U përgatita me aq sa munda dhe fshiva lotët, të cilët më kishin pastruar sytë... I dhashë leje turpit tim për të qenë i pranishëm në këtë takim... Kalova me guxim ngacmimet e shejtanit dhe u bëra ballë atyre...

Më në fund i rreshtova fjalët e mia në një fjali që nuk përmbante më fjalën: "ndoshta" .. Ti do të vish thashë... Pavarësisht çdo gjëje, ti do të vish... Ti nuk do të më turpërosh mua... Do të vish për të më mbuluar me perden e bardhë që më mungon...

Dhe ti erdhe... Çdo gjë brenda zemrës sime u thërrmua . Por çdo gjë u rregullua, ajo rrëmuja që ekzistonte, u zhduk sa hap e mbyll sytë. Sytë e mi shkëlqyen duke harruar çdo gjë të gabuar që kisha bërë...

Fillova të të thërras me ato salavate që i kisha mësuar në fëmijëri dhe ashtu me atë pamjen e vajzës së vogël të prita Ty duke shkruar fletën e fundit tek ditari im i ndoshta-ve...

Dhe tashmë e di i Dashur Pejgamberi im, sytë e mi po shkëlqejnë...



Të jesh nënë

Kur fillon të ndjejë dhimbjet që i servir jeta, njeriu kërkon të mbysë kohën, sepse duke e bërë këtë gjë nuk kujtohet për dhimbjet e shpirtit.

Mënyra më e mirë për të vlarë ose shtrënguar kohën është jetesa e shpejtë.

Kur njeriu merret gjatë gjithë kohës me punë të ndryshme dhe nuk lë asnjë minutë të harxhohet më kot; në fund të ditës nuk gjen më kohë për t'u kujtuar për dhimbjen e tij.

Që fëmijë jemi mësuar me metodën e të punuarit gjatë gjithë kohës për të harruar dhimbjen. Ky është një veprim që kemi vazhduar ta bëjmë gjatë gjithë jetës sonë edhe kur rritemi, por në këtë mënyrë ne fitojmë edhe refleksin e të qenit

të pandjeshëm ndaj njerëzve të afërt dhe në veçanti ndaj bashkëshortit dhe fëmijëve.

Shprehja që dëgjohet më shumë në familjet e divorcuara, është: "Bashkëshorti im nuk më kupton." Në fakt, nuk është i vërtetë fakti që bashkëshorti nuk i kupton, e vërtetë është se ata nuk duan të mirëkuptohen.

Një njeri i cili është mësuar gjithmonë të mundohet t'i kuptojë njerëzit që e rrethojnë, nuk ka pse të ketë vështirësi të kuptojë gruan / burrin.

Për fat të keq, njerëzit e sotëm nuk përpiqen të shijojnë jetën në çdo vend: në vendet ku shkojnë për pushime, në vendet e argëtimit, në rrugë dhe bile edhe në stacionet e autobusit. Njerëzit e so-

tëm gjatë gjithë kohës bëjnë përpjekje për të mos e ndjerë jetën dhe dhimbjen që ajo nganjëherë sjell tek ne. Sa dramatik është fakti që ky stil jete- se është kthyer në një formë arti dhe zotësie.

Gjëja më e trishtueshme nga të gjitha këto është fakti se këta prindër, që janë të stërvitur për të mos ndjerë asnjë gjë janë ata që do të rrisin një brez të tërë fëmijësh moskokëçarës për askënd.

Këtu mund të japim shembullin e një gruaje, e cila përpriqet ta jetojë jetën e saj me një tempo të lartë dhe në të njëjtën kohë, duhet të jetë nënë për fëmijën e saj. Le të shikojmë pasojat që vihen re tek fëmija:

Fëmija (pavarësisht moshës) është në gjendje ta kuptojë mungesën e dashurisë së plotë të nënës së vet dhe për ta zhdukur këtë dhimbje i drejtohet nënës me mënyrat që zotëron.

Ky fëmijë mundohet ta shkatërrojë guaskën e fortë që ka ndërtuar nëna e tij rreth vetes, këtë guaskë, që nuk e lejon të ndjejë dhimbjen e njerëzve rreth e rrotull. Fëmija mundohet ta vjedhë vëmendjen e nënës nga të gjitha gjërat e tjera të cilave ajo u kushton kohë.

Fëmija përpriqet me çdo kusht që nëna të jetë pranë tij dhe t'i kushtojë kohë atij dhe për këtë ai mundohet t'ia ngushtojë kohën për t'u marrë me gjërat e tjera. Për shembull, kur nëna është duke folur në telefon, ai kërkon t'ia marrë telefonin nga duart; shkon në një dhomë tjetër dhe bën zhurmë me diçka ose grindet me vëllain e vogël vetëm për të bërë zhurmë.

Gjithashtu edhe në rastin kur nëna merr një libër në duar për ta lexuar, ai kërkon t'ia marrë nga duart.

Të gjithë këto çapkenllëqe që bëhen nga fëmija, kanë vetëm një qëllim: kërkimin e interesit dhe dashurisë së nënës.

Sipas vëzhgimeve, ky proces përfundon në dy mënyra:

E para: të gjitha këto përpjekje të fëmijës e çojnë nënën në gjetjen e një rrugëdaljeje. Në momentin kur nëna gjen burimin e problemit, ajo shikon në mënyrë më objektive veprimet e veta. Pra, nëna e kupton se ajo mbyttje që është përpjekur t'u bëjë ndjenjave të saj e ka ndikuar edhe fëmijën. Ajo kupton se refleksi i saj për të jetuar jetën pa e ndjerë atë, pa e dashur atë; ka mbytur edhe in-

stiktin e saj mëmësor. Kur nëna e kupton gabimin e saj, ka nevojë për një periudhë kohore rehabilitimi psikologjik. Nëse nëna e merr këtë iniciativë dhe e rifiton aftësinë e të ndjerit, për të fillon një jetë e re. Për një njeri i cili ka jetuar për një kohë të gjatë në një botë të ngurtë, nuk ka asgjë më të bukur dhe më qetësuese se sa rifitimi i ndjenjave të humbura. Një nënë që e jeton këtë ndjenjë fillon të ndryshojë rrënjësisht veprimet e veta. Ajo e shikon botën me një sy tjetër, e mirëkupton bashkëshortin dhe e ndjen më të qartë ndjenjën e amësisë. Kupton se sa kënaqësi e madhe është roli i prindërit, ai rol që më përpara dukej vetëm një barrë e bezdisshme.

Kjo nënë e ndërgjegjësuar, tashmë nuk sillet me nerva dhe ankesa ndaj fëmijës së saj, por me mëshirë e kujdes.

Fëmija është një dhuratë e Zotit për prindërit, që i ndihmon ata të rregullojnë gabimet e veta.

Fatkeqësisht, jo gjithmonë ndodh kështu.

Shumë herë, të gjitha përpjekjet e fëmijës për të tërhequr vëmendjen e nënës përballen me përgjigjet nevrrike të nënës. Këto kërkesa për interes dhe dashuri i duken nënës si diçka e bezdisshme dhe e vështirë për t'u përballuar, prandaj ajo mundohet ta largojë sa më shumë fëmijën e saj. Nëna e largon nga vëllai i vogël fëmijën që e xhelozon vëllain e vet, që i duket se zotëron dashurinë e nënës; në momentin kur fëmija kërkon t'ia marrë nga dora librin që po lexon, nëna shkon për t'u mbyllur në një dhomë; ndërsa, kur fëmija e shqetëson në momentin që po flet në telefon, ai bindet me dhunë për të mos e bërë më një gabim të tillë.

Kur të gjitha këto përpjekje nuk kanë një përfundim pozitiv, fëmija detyrohet të ndjekë një rrugë tjetër.

Njëra prej këtyre rrugëve është pranimi i humbjes së kësaj beteje dhe fillimi i vuajtjes që vjen nga mungesa e dashurisë... Në këtë mënyrë, fëmija do të shijojë një nga vuajtjet e para në jetë, si pasojë e humbjes së dashurisë së nënës. Pas një periudhe të shkurtër kohore fëmija do të mësojë se si t'i mbysë këto ndjenja pozitive dhe fiton një eksperiencë që do t'i shërbejë gjatë gjithë jetës.

Por kishte diçka që nuk shkonte. Përreth filloi të bëhej tym e pluhur dhe grimca e parë e pluhurit preku trupin tim... Bardhësia që prisja këtë herë nuk ishte tregues i pastërtisë që unë mendoja. Çdo grimcë pluhuri që binte, ma gjakoste trupin... Dhe në gjithë atë kopsht me aromë të mirë, rrobat më mbuloreshin me gjak...



Fshihja fytyrën. Bërtisja "Jo!" dhe largohesha duke shkelur lulet të cilat më dhimbseshin edhe t'i kundërmoja... Fytyra duhet të qëndronte me mua, e jo të shfaqej vetëm kur isha para pasyqrës. E fshihja atë me duar, që të mos përzihej me trupin e gjakosur... Dhe si një i pashpresë që ka ardhur në fund të rrugës, i shtrirë përtokë me frymë të prerë, qaja duke klithur dhe tretesha.

Kur hapa sytë, pashë se bardhësia e tavanit ishte shumë e madhe dhe nuk kisha menduar kurrë se një ditë do të frikësohesha nga ajo. Ky makth i kishte fshirë të gjitha ngjyrat tek unë. Atë mëngjes u zgjova me shpirt të errët, por me fytyrë krejt të bardhë... Lotët më kishin ndjekur me gjithë vërtetësinë e tyre në atë botë derisa u zgjova...

Lava duart e fytyrën dhe i hapa të gjitha dritaret që pashë për të zgjeruar shpirtin e ngushtuar. Doja ta bindja veten që nuk isha vetëm dhe shpresova te televizori duke e bërë ekzistencën e asaj jete të rreme ngushëllim për mëngjesin tim. Ky makth, në fakt, diku brenda meje ishte i vërtetë për gjithë ato vite që kisha jetuar... Nga kjo ishte edhe ngritja e zërit të muzikës deri në fund... Çdo gjë ishte për të shtypur zërin e kësaj të vërtete brenda meje...

Makthi i këtij pluhuri të bardhë që e fillova vite më parë, u bë fatkeqësia ime. Kur bija në gjumë, tregimi im nuk ishte aq i pafajshëm sa gjërat që përjetoja, por fundi në çdo rast ishte i njëjtë; gjithmonë tretesha...

Jam shumë e pikëlluar, shumë e pashpresë, e lirë dhe e vetme. E di jetën, kisha vetëm një shans për t'u zhytur në thellësitë e jetës, këtë shans duhet ta përdorja mirë!.. Nuk duhet të mërzhitesha dhe duhet të harroja çdo gjë... Ja unë, unë duhet ta lëndoja çdonjërin që më donte për të qenë njeri dhe nuk kishte mëkat muzgu im në dhomat që binin erë të keqe... Dhe unë zgjodha një ngjyrë për makthin tim; e bardhë do të ishte ngjyra e historisë sime.

Sa herë që të dashurit e mi fantazma më dhuronin atë ngjyrë të bardhë, mendoja edhe njëherë se isha unë. Mendova se mund t'i pastroja me këtë helm të bardhë imazhet e mia që mbanin erë të pistë... Dhe në të vërtetë, zbulova se si do të tretesha e do të konsumohesha!

Çdo frymëmarje ma mbulonte botën me avull. Në dhomën time bëja qeshje të rreme, që nuk i kisha përjetuar asnjëherë në vende që kurrë nuk kisha qenë... Çdo qelizë po më braktiste. Por nuk më vinte keq, sepse e dija se isha sundimtar i bardhësisë... Në fakt mendoja se ishte një mashtrim i mjerë...

Nuk më bënte përshtypje as që me kalimin e kohës turpërohesha me fjalitë e mia të ulëta...

Po fytyra? Nëse rastësisht qëndroja më shumë se ç'duhet para një pasqyre, dëgjoja ata zëra që ma bënë zemrën të qante me dënesë. Ku jam unë? Ku është fytyra ime e bukur? Çfarë është kjo bardhësi e vërtetë?

Në mendje më vinte zëri i nënës sime që mbante erë mëshire... Për të ikur nga këto debate, mbyllesha vazhdimisht në një vend... Rrihja bashkë me zemrën në fund të errësirës... Dhe ngecja në çdo frymëmarrje pesimiste... Ndërkohë që makthi i pluhurit të bardhë e mpinte trurin tim, në të vërtetë ktheheshin të gjitha imazhet e mia... Kur jeta ime po tretej në atë zjarr, përbrenda digjia edhe justifikimet e mia!

Duhet ta bëja! Duhet të pastrohesha nga shqetësimet e mia... Duhet të hakmeresha ndaj kësaj jete më të gjatë se unë... Duhet t'i tregoja kësaj bote se kush isha dhe se do ta mposhtja! Unë nuk e dija të vërtetën... Po mundohesha ta shkatërroja këtë krijim pa e ditur se përse isha krijuar! Në fakt inatin e kisha me veten, por nuk mund ta pohoja...

Kujt t'i kërkoja llogari për atë boshllëk që e kisha rritur përbrenda me kujdes? Mbi kë ta lëshoja këtë furtunë makthi, mbi nënën apo babain? Nuk e dija se ku ndodhesha, nuk e dija nëse ishte dikush që të më shpëtonte dhe nëse unë dëshiroja me të vërtetë të shpëtoja.

Kjo ikje drejt fundit duhet të mbaronte pa i shtuar forcë të zezës që lindi brenda meje nga e bardha. Një ekzistencë duhet të më tërhiqte me madhërinë e saj dhe të më sillte në vete.

Një zë më pëshpëriti në vesh... Ai zë ashtu i pastër e i qartë shumë ndryshe nga të dashurit e mi fantazma... Nuk më premtonte bardhësinë dhe nuk më ftonte për në errësirë. Më thoshte se më do, por kjo vepronte brenda meje. Shpallte se ishte poseduesi im dhe më tregonte si qëllim vetëm lumturinë.

Më shtonte mua dhe vlerat të ëndrrat e mia dhe kështu shprehte bukurinë time. E mbushte me shumë kujdes shpirtin tim me fjalitë lumturuese, të cilat dëshiroja me gjithë zemër t'i dëgjoja. Ajo fjalë, ai zë ishte mesazhi i Krijuesit tonë të Madhëruar, i cili më do mua më shumë se ç'dua unë veten.

Dhe tani unë, e pastruar nga papastërtitë e një bardhësie të rreme, po zhytem përsëri në gjumë për të pritur një dorë lutjeje që të më zgjojë nga një makth në këtë botë. E di se bardhësia që do të vijë këtë herë nga qielli, do të jetë lajmëtari i ëmbël i pendimit për mua.



Kubra Çoban

Dëshira dhe Ura

Na duhet i dashuruari, na duhet i Dashuri, na duhet Prijësi!

Mbi Siratin, na duhet Prijësi më i madh!

Nëse e ke kokën lart, ballin e hapur dhe je i përmalluar për Allahun, mos ki frikë! Mos shko pas çdo dëshire duke e pandehur të bukur! Disa gjëra e kanë pamjen e bukur, por gjendja e brendshme e tyre është e dëmshme për dikë... Ndërsa ti vrapoje pas mollës si një fëmijë naiv, në brendësi të asaj molle është vendosur helm... Thuaj:

"Çfarë ndodhi, nga na doli tani kjo temë?"

Zëre se u helmova dhe u dogja. Ja, një ndjenjë përbrenda më tha:

"Trego, mos të të ngelet peng."

Sepse mbi Sirat njeriu duhet të jetë i pastër. Duhet një njeri që është strehuar në zemrën e murshidit! Duhet dëshira të sinqerta, që i zgjidhin hallet dhe jo fytyra të maskuara me lëkurë të veçantë dhe brendësi të kalbur.

Ti dëshiroje të thoshe "Ejvallah" për çdo gjë që vjen prej Tij. Qenka e lehtë të kërkosh, apo jo? Por e vështirë për t'u jetuar! Ndërkohë që ecën me shpejtësi mbi Sirat, nëse të ka rrëshqitur këmba, dije mirë se ke pasur nevojë për atë rrëshqitje! Ndoshta e ke pandehur veten të vyer... Allahu të fali dhe ta uli hundën e cila të ishte ngritur përpjetë.

Ndoshta kishe nevojë për ato që ke jetuar në mënyrë që çdo njeri ta shohësh të bukur. Kujto!.. Se si me një shikim tëndin i fusje në fund të dheut njerëzit të cilët i pandehje mëkatarë! Si ecje në tokë me kokën lart dhe i sigurt? Ja, erdhi dita dhe koha u kthye! Erdhi çasti! Erdhi koha kur ti do të plotësosh të gjitha dëshirat e tua. Tashmë të shpie i dashuri! Te ai sundimtar, të

shpie bindja!

Përvishu, sepse e pe që nuk ka dobi! Kthehu nga "Dielli", nuk mund të ngrohesh në "Hënë"! Mbi Sirat duhet një kokë e nënshtruar! Nuk duhet një shok fals, por një i vërtetë!

Ti je si dallgët që shkojnë e vijnë. Përpiqesh të kuptosh. Zemra jote përqendrohet në çlirimet e urtësisë... Mundohesh të kalosh muret dhe gjakosesh gjithandej. Pastaj thua se sa e vështirë është të sfidosh çdo gjë që të del përpara! Është shumë e vështirë. Mësimi yt i vetëm është:

"Harroje ligësinë që të është bërë!"

Për ta dhënë këtë mësim, duhet t'i lëshosh të gjitha dëshirat në një përpjekje serioze, sepse, nëse nuk dëshiron të përpiqesh seriozisht, nuk ke forcë për asgjë. Dhe lutjet duhet të të shoqërojnë, sepse nuk mund të përparosh pa lutje. Beli të është përkulur. Shpirti ka prekur tokën. Do të thotë se këto qenkan të domosdoshme për të arritur dëshirën përfundimtare. Qenka e vështirë të përballesh me nefsin, të derdhësh gjak pa dobi dhe të përballosh plagët apo jo? Atëherë urdhëroje veten:

"Munde të keqen me të mirë!.."

Mos e harro shkaktarin kur të nderon e të jep mirësi dhe kur të sprovon me ndonjë fatkeqësi. Çdo gjë përveç Tij, është vetëm shkak! Madje një shkak i vogël në botën e shkaqeve...

Kalo, sepse në fund të rrugës të pret xheneti i lartë! Brenda çdo vuajtjeje të pret një lumturi e ëmbël. Mbi Sirat duhet një shpirt me shpresë të pashuar! Duhet një dorë besimtare, që nuk është zgjatur në haram!

Ai që dëshiron oqeanin, gllabërohet edhe nga vorbullat! Kush zhytet në oqean, edhe përplaslet me

dallgët. Pandehe se kjo është një fatkeqësi! Jo! Ajo që të ka ndodhur është provim i pohimit "Bela"¹, që e ke thënë në botën e shpirtit. Ti u përgjigje me "Bela" pyetjes: "E lestu bi rabbikum?"²

Ti u përgjigje: "Bela! Ti je Zoti im."

Ai po të tregon për veten e tij, që të njohësh veten tënde. Si mund ta kuptosh madhështinë, fuqinë dhe mëshirën e Tij, nëse nuk di paaftësinë, mangësinë dhe dobësinë tënde? Si do të dish të strehohesh?! Tani, ndërkohë që ti rrotullohesh me kokën që të ka ngelur në vorbull, për më tepër do të qetësosh edhe ata që të ndjekin. Do t'u thuash:

"Mos u mërzitni! Po na sprovon! Mos u shqetësoni! Po na sprovon..."

Ta bësh këtë, nganjëherë është e vështirë, nganjëherë më se e vështirë. Por çfarë t'i bësh, kjo ndodh dhe të ra ty për pjesë... Mbi Sirat duhet zemër me dashuri! Duhet sakrificë për hir të të Dashurit!

Një ditë u lute për dikë:

"Allahu të dhëntë çfarë të të dojë zemra!"

Ai të tha:

"Jo..."

U habite. Ai njeri i devotshëm ta shpjegoi:

"Pse u habite? Unë nuk i besoj zemrës sime! Zemra dëshiron të mirën dhe të keqen. Kërkon të dobishmen dhe të padobishmen. Unë nuk i besoj dëshirës së zemrës sime, por lutu që dëshira e Tij të jetë edhe dëshira e zemrës sime. Atë gjë që Ai dëshiron për mua, të mos e ketë të vështirë dhe të rëndë nefs im."

Atëherë u ktheve dhe vështrove gjendjen tënde. Pe që kishe shumë dëshira, krahët e të cilave ishin si oktapodë të mëdhenj që mundoheshin të arrinin çdo vend dhe që shtriheshin me dëshirë te çdo gjë që shikonin. Kur kuptove se çdo anë e jotja përbëhej nga dëshira, u habite. Dukej sikur disa nga dëshirat të çonin në derën e xhenetit, disa të tjera në gropën e xhehenemit. Pastaj pe që Sirati ishte shumë i rrëshqitshëm. Ja, atë ditë kuptove se:

"Nuk duhet t'i besosh çdo dëshirë që hyn në zemrën tënde dhe ta merr mendjen!..."

Ndonjë dëshirë, edhe pse të duket e mirë, është e keqe. Ndonjë tjetër, edhe pse të duket e keqe, është e mirë... Mbi Sirat të duhet një trim që të shpie ty te Allahu! Të duhet një njeri që të shpëton e nuk të lë në rrugë!

Kujto! Kur ti nuk dije akoma të kërkoje, notoje brenda një pishine të vakët larg shqetësimeve. Çdo gjë për të cilën kishe nevojë, ishte nën urdhrin tënd. Allahu të nxori nga uji ku notove për nëntë muaj me

radhë dhe more frymë për herë të parë. Për më tepër, atëherë nuk e dije madje se kishe nevojë për këtë. Kur nuk dije të kërkoje, Allahu Mëshirëplotë ta dhuroi këtë për të mirën tënde. U dogje përbrenda dhe qave! Ardhja jote në jetë ishte klithmë e rënkim... Ato kohë rrugën e kishe të shkurtër, nuk zgjati shumë për t'ia arritur qëllimit...

Në fillim deshe një mbulesë të ngrohtë me të cilën të mbështollën, pastaj kërkoje një krahavor plot dashuri dhe të përqafuan fort. U drejtove nga qumështi. Të dhanë gjë dhe të ushqyen që të ngopeshe, të rriteshe dhe të mos qaje. Ishe i pafajshëm. Të deshën dhe t'i duruan tekat. Ishe shumë i ëmbël dhe mbi të gjitha aq i pastër, sa që kujtudo që të shikonte, i kujtoje Allahun. Sirati yt qëndronte mbi xhenet. I mbështjellë me lule shumëngjyrëshe.

Erdhi koha që u mërzite prej këtyre... Pastaj, siç ndodh gjithmonë, fillove të mos e ndjesh ekzistencën e **"frymës"** tënde. E pandehe tënden. Në fakt të plotësonin edhe nevojën e ujit. Ishe i qetë. Por përsëri zemra të kërkonte më shumë. Nuk të mjaftoi ajo që pive dhe the: "Më jepni më shumë!" Allahu ta mundësoi. Lëshoi shiun nga qielli... Nganjëherë falënderove, nganjëherë u mërzite dhe the "edhe ky na duhej!" Sirati yt akoma qëndronte mbi xhenet. Këto zemërime përbëheshin edhe nga imitimi i më të mëdhenjve.

Sigurisht që nuk u mjaftove me kaq. Nuk dite të ndaleshe. Pe se kishe ajër të mjaftueshëm dhe ujë të rrjedhshëm. Kështu që u drejtove tokës këtë herë... Kërkoje të luaje. U lyve kokë e këmbë me baltë. Sa i ëmbël bëheshe madje edhe kur majën e hundës e kishe me baltë. Pastaj edhe nëna nuk të qortonte, sepse ishe shumë i shtrenjtë për të. Për më tepër, e dinte se balta nuk ishte e pistë, por shëruese.

Kur vije në mbrëmje, të lante mirë e mirë... Zhyteshe menjëherë në gjumë me ndikimin e ujit të ngrohtë. Sirati yt akoma ishte sipër një kopshti.

Rrugë është kjo. Majtas-djathtas ka pamje. Kujto zjarrin, ditën e parë që e ke parë. Si t'u hapën sytë nga habia. Çfarë ishte kjo! Ç'gjë e çuditshme! Çdo gjë që gjeje, doje ta prekje me duar. Doje ta njihje më nga afër dhe ta zbuloje. Prandaj edhe balta të qetësonte. Ngaqë mund ta prekje. Por sa keq që këtë herë nëna nuk të lejoi. Të tha me frikë:

"Kujdes! Mos e prek se digjesh!"

U bëre shumë kureshtar për zjarrin, ndoshta ngaqë për herë të parë pe se ta ndaluan në këtë mënyrë. Nuk kishe qëllim të keq. Në rastin e parë që t'u dha, u zgjate, e preke dhe dora t'u dogj. Sirati yt akoma qëndronte mbi xhenet. Ti qaje nga djegia e dorës.

Shtatë vitet e para të jetës u njohe së tepërmi me

1. Po.

2. A nuk jam Unë Zoti juaj?



botën. Çfarë ishte dynjaja? Një botë e përbërë nga ajri, uji, toka dhe zjarri... Shikoj gjendjen tënde të sotme:

Kërkimi yt pa fund. Nuk qenke kënaqur nga asgjë që të është dhënë. Por mbi Sirat duhet një nefsi mutmain (i qetë, i bindur)! Duhet një kafaz i hollë që i ka liruar zogjtë!

U rrite. Kërkove që "të të përkasë ty" shumica e ajrit, ujit, tokës dhe që zjarri të të nënshtrohet. Ndërkohë që rriteshe, t'u rrit nefsi dhe dëshirat... Sirati filloi të nxehej poshtë dhe duart filluan të të kruheshin me animet e tua. Megjithëse ishte i dashur dhe i pafajshëm, të dolën njolla. Nga çdo anë dyert ishin të hapura ndaj çdo rreziku. Me kalimin e kohës çdo gjë ndryshoi ngjyrë dhe formë. Sirati t'u hollua. Trëndafilat që ishte mësuar t'i shohësh në fëmijëri, u kthyen në topa zjarri. U bërë bashkëbisedues jo vetëm i xhenetit, por edhe i xhehenemit. Fillove të kesh përgjegjësi.

Ndërsa nevojat e tua ishin akoma vetëm katër: ajri, uji, toka dhe zjarri. Ja që edhe atyre u ndryshoi esenca. Ato u kthyen në gjëra të huaja, jo për shkak se u mjaftove me ato që kishe, por ngaqë e neglizhove falënderimin e Zotit për to, sepse ishin gjithmonë të gatshëm dhe pa kundërvlerë. Ua ndrydhe fytyrat.

Përsëri **"el-Kerimi"** (Bujari) nuk ndaloi së dhëni. Kërkove shokun e jetës, ta dha. Të dha punë, rroba e pasuri. Të dha pozitë, vend, kohë, mundësi, çdo gjë. T'i dha, por ti sikur e harrove dhënësin. Asnjëherë nuk ndalove dhe u more me gjëra të padobishme. Ndërkohë që frymëmarrjet e tua shumoheshin, shumoheshin edhe dëshirat. Ndërsa shumoheshin dëshirat e tua, edhe zëri yt... u bë shumë i madh. Dëshira jote u bë monstruoze! Pandehe se nuk do ta nxinin dyert. U zmadhua! U tërbua! Deshe hyritë, ama nuk e braktise fëmijërinë. Por nëna të pat thënë:

"Mos e prek se digjesh!"

Shiko çfarë mëshire; edhe zjarri është lloj-lloj. Nuk ekziston vetëm zjarri i xhehenemit, i cili vlon poshtë Siratit! Është edhe zjarri i dashurisë, të cilin e dinë vetëm ata që bien brenda saj. Faktikisht, kur nuk mashtrove asnjë gjë, syri yt u hap ndaj saj... Tani dëshiron të dashurohesh, dashuria nuk është një rrobë që mund ta veshë kushdo! Duhet që kallëpi

i saj të jetë njeri. Ajo kërkon burrëri. Nëse je trim, thuaj amin lutjes që po bëj për ty: "Tashmë u bësh dëshirues dhe arritës vetëm i kënaqësisë së Allahut (xh.xh.)!..."

Ndonjëherë hap duart, ndonjëherë zemrën. Moti nganjëherë bëhet me shi, nganjëherë me re. Ndonjëherë lotin e kam të turbullt, ndonjëherë të qartë. Dhe zjarri nganjëherë e djeg, nganjëherë e pjek zemrën time!.. Por përsëri unë lutem në mungesën tënde. Dhe ndërkohë që përgjerohem për ty, përgjerohem edhe për vete, sepse nuk kemi shumë ndryshim. Them:

"Mes dëshirave të panumërta që ke vënë në zemrën time, më e forta është dashuria. E di që do të më sprovosh me shumë vepra të tjera. Meqë kjo është gjendja, bëje dëshirën time Tënden, o Zoti im! Më jep forcë të jem i kënaqur nga vullneti Yt. Më mbro nga dobësitë dhe kërkesat me maskë dëshire që më vijnë rrotull!..

Secili e ka një Zot. Bëhu Ti Zoti i vetëm i zemrës sime! Bëhu që të largohem nga haramet "vetëm nga frika se humb dashurinë Tënde". Bëhu Ti çështja ime më delikate! Mbushma zemrën me dashurinë e vërtetë ndaj Teje dhe jo me hallin e pozitës, parasë, të kësaj e asaj dhe që të mos bëhem nga mashtuesit që dalin gënjeshtarë në fjalën: "Jam i dashuruar!"

Siç e ke edukuar me Javuzin atë që thoshte: "Atë që adhuron ju, është nën këmbët e mia.", po ashtu, edukoji edhe ata që thonë: "Zoti ynë është Allahu!.." Mos e harxho veten për dëshirat e tua dhe mos e bëj atë (veten) e as ne prej atyre që mbyllen në kafaz. Mos na bëj prej atyre që mashtrojnë, që vjedhin, që e teprojnë dhe që i kalojnë kufijtë në jetën intime të të tjerëve pa pasur të drejtë! Ji dëshira jonë që duam shumë! Dëshirën tonë shkrije në vullnetin tënd! Na afro te dëshirat që na afrojnë tek Ti dhe na largo nga dëshirat që na largojnë nga kënaqësia jote!

Mbi Siratin na duhet një kalë i fuqishëm! Na duhet vullneti i Allahut e jo dëshirat e tua!

Deri sa të vijë koha e lutjes, në gjuhën time do të ngelësh si një ah, në zemrën time si një dhimbje dhe në sytë e mi, si një shikim i dhimbshëm. Atë ditë kur zemra jote plot shpresë të kërkojë vetëm Rrahmanin, ja, atë ditë, do të jesh shpirti im! Ja, atë ditë, ndoshta do të arrijmë bashkë dëshirën tonë. Sepse, siç jemi sot bashkë, edhe nesër mbi Siratin do të jemi bashkë në zemrën e të njëjtit prijës.

Atëherë, ne na duhen dy sy të djegur që shikojnë! Mirësia nuk është një fjalë e thatë. Rugës i duhet një sakrificë e vërtetë. Na duhet i dashuruari, na duhet i Dashuri, na duhet Prijësi! Mbi Siratin na duhet Prijësi më i madh!

BOTA E PËRKOHSHME DHE AJO E PËRJETSHME



Kjo botë dhe kjo jetë që ne po jetojmë është kalimtare. Ky është vendi i sprovave. Për askënd jeta nuk është krejt e lumtur dhe pa probleme. Çdokush vuan në mënyrën e vet. Në këtë botë, ditët e vështira dhe të mbushura me shqetësime janë më të gjata dhe më të shpeshta se ditët e bukura dhe të lumtura.

Siç është përmendur edhe në hadithe, kjo botë është burgu i besimtarit dhe xheneti i mosbesimtarit, sepse, sado që të jenë të shumta të mirat e kësaj bote, ato nuk mund të krahasohen kurrë me mrekullitë dhe dhuratat e pafund të xhenetit. Begatitë e xhenetit janë pa të meta dhe nuk mbarojnë kurrë. Kurse në këtë botë çdo gjë ka diçka që mungon gjithmonë.

Për jobesimtarët kjo botë është si një parajsë, sepse sado i mjeruar të jetë në këtë botë një njeri që nuk i beson Allahut, në botën tjetër do të vuajë aq shumë, sa kjo botë do t'i duket atij si xhenet.

Ndëshkimi i xhehenemit është i pamëshirshëm dhe i pafund...

Begatitë më të mëdha të një besimtari në këtë botë janë besimi dhe shëndeti. Për një njeri që beson, të gjithë vështirësitë e kësaj bote janë të parëndësishme dhe të lehta për t'u kapërcyer. Pejgamberi ynë i nderuar ka thënë: "Besimtari është i fituar edhe kur ndodhet në vështirësi, edhe kur ndodhet në bollëk."

Njerëzit që e ulin kokën në vështirësi dhe i nënshtrihen fatit të tyre, janë gjithmonë të fituar.

Gjithashtu edhe njerëzit, të cilët janë falënderues për të mirat e shumta që Allahu u ka dhuruar, janë të fituar.

Nga kjo kuptojmë që njeriu, i cili ka besim në zemër të vet, është i fituar si në ditë të lumtura ashtu edhe në ato të vështira. Për sa kohë që njeriu u bindet urdhrave të Zotit, është i lumtur.

Egoja e njeriut është mosmirënjohëse dhe e pangopur. Njeriu, edhe sikur të jetë zotërues i gjithë botës, kërkon dhe një botë tjetër. Ai nuk i kujton ditët e bukura, por e kalon kohën duke u ankuar për problemet e veta.

Në këtë botë ka vetëm një gjë të rëndësishme, ajo është kujtimi në çdo çast dhe në çdo vend i vdekjes.

Pejgamberët e nderuar, njerëzit e mirë, gjyshërit tanë, prindërit tanë.. të gjithë kanë hyrë një nga një në dhe. Tashmë nuk ka asnjë shenjë që vërteton ekzistencën e tyre; shumë prej këtyre njerëzve janë harruar krejtësisht.

Vetëm njerëzit e mirë kanë hyrë në tokë? Farao-nët e plotpushtetshëm, Ebu Xhehilët; a nuk kanë vdekur? Ku ndodhet tani krenaria dhe mosbesimi i tyre i madh sa malet? Këta njerëz mendjemëdhenj, nuk janë bërë dhë tashmë? A nuk ka mbirë bari mbi varret e tyre? A nuk kalojnë mbi ta njerëzit dhe kafshët e ndryshme?

Sigurisht që ajo që po u ndodh atyre, një ditë do të na ndodhë edhe neve!.. Ashtu si ata edhe ne një ditë do të varrosemi dhe do të mbesim vetëm me rezultatin e veprave tona?! Do të japim llogari për atë që kemi bërë në këtë botë.

Sot është dita që duhet të veprojmë, në mënyrë që kur të vihem përpara llogarisë, të mos turpërohemi.

Dr. Beryl Inall



Qumështi i nënës

Çështja e të ushqyerit, siç është e rëndësishme gjatë shtatzënisë, është e rëndësishme edhe gjatë periudhës së gjidhënies. Bebjë, e cila ushqehet në mitrën e nënës me anë të kordonit, pasi të vijë në jetë do të ushqehet me qumështin e nënës që është një mrekulli dhe kështu do të vazhdojë të rritet e të zhvillohet.

Veçanërisht, ngaqë ushqyerja vetëm me qumësht gjiri në gjashtë muajt e parë të jetës është shumë e rëndësishme, nëna duhet t'i kushtojë shumë kujdes ushqyerjes së saj. Para së gjithash, nënat asnjëherë nuk duhet të harrojnë se faktori më i rëndësishëm për ardhjen dhe vazhdimësinë e qumështit është ushqyerja e bebes me gji.

Ndërkohë që fëmija ushqehet me gji, qumështi vazhdon të vijë. Në të njëjtën mënyrë, edhe në kohën e ndërprerjes së gjidhënies, gjëja që duhet të bëjnë nënat është të mos e ushqejnë beben për një kohë. Si përfundim, qumështi i gjirit me kalimin e kohës pakësohet dhe zhduket.

Ajo që duhet të bëjnë më së shumti nënat kur ushqejnë beben me gji, është të dëshirojnë me të vërtetë ta ushqejnë atë me gji. Vetëbesimi, të menduarit me dashuri dhe mëshirë për beben, lidhja trupore me beben; ndërkohë që rrjedhja e qumështit ndikon pozitivisht, dhimbja, stresi, shqetësimi, frika dhe dyshimet mund të ndikojnë negativisht. Për shembull, kur nëna tundohet nga kritikrat si "qumështi yt nuk i bën dobi bebes, ti nuk e ke qumështin e ëmbël, nuk mund ta ushqesh beben me gji, jepi ushqim dhe të flejë, shiko sa e shëndetshme është bebjë e fqinjit, etj.", stresohet dhe kjo e pengon rrjedhjen e qumështit.

Nënat, sidomos në periudhën e gjidhënies, duhet të mbështeten nga të tjerët dhe nuk duhet të mërzhiten me fjalë të kota. Sa të ketë mundësi duhet të qetësohet, duhet të flejë ndërkohë që bebjë fle dhe nuk duhet të qëndrojë shumë pa gjumë. Një nënë e vullnetshme dhe e mbështetur psikologjikisht në çështjen e gjidhënies, edhe pse ndonjëherë mund të dobësohet, mundëson një periudhë të suksesshme gjidhënieje.

Afërsisht 80% e energjisë që merr një nënë që ushqen beben me gji, kthehet në energjinë e qumështit. Dietës së një nëne të shëndetshme që jep 800 ml qumësht në ditë, duhet t'i bëhet shtesë 750 kal. 2/3 e kësaj mundësohet nga ushqimet që ajo konsumon, ndërsa 1/3 nga depozitimi që është bërë gjatë shtatzanisë. Pra, një nënë që është ushqyer në mënyrë të ekuilibruar dhe cilësore gjatë shtatzanisë, dobinë e kësaj do ta shohë gjatë gjidhënies.

Një nënë gjidhënëse duhet të tregojë kujdes në marrjen e mjaftueshme të lëngjeve dhe konsumimin e ushqimeve që janë të pasura me proteina, kalcium, hekur dhe vitamina. Burimi i proteinave nuk duhet të jetë vetëm bimor. Nëse dietës ditore të nënës i shtohet një vezë ose 1-2 gota qumësht, mundësohet mbështetja e proteinave ditore.

Anemia është një problem tjetër i rëndësishëm, me të cilin përballemi gjatë periudhës së gjidhënies. Sa kohë që me anë të dietës nuk merret hekur i mjaftueshëm, kjo mbështetje duhet të bëhet me tabletat ditore.

Nevoja e kalciumit gjatë gjidhënies shtohet. Kjo nevojë duhet të plotësohet, që kockat të mos dobësohen, prandaj dietës duhet t'i shtohet një gotë qumësht, një gotë kos dhe djathë (sa një kuti shkrepëse). Nëse perimet dhe frutat e freskëta të stinës i përgjigjen nevojës për vitamina, ato (vitaminat) nuk duhet të merren me tableta dhe pa rekomandimin e mjekut, por duhet të përdoren nën mbikëqyrjen mjekësore.

Gjatë gjidhënies, sasia e lëngjeve që duhet të merren është afërsisht 3.000 ml. Pra një nënë që ushqen beben me gji, në ditë duhet të pijë 12 gota ujë, qumësht, komposto, dhallë, limonadë ose lëng frutash. Çaji ose pijet me kafeinë, si kafeja nuk është mirë të konsumohen, ngaqë ndikojnë negativisht te struktura e qumështit dhe shtojnë humbjen e lëngjeve. Gjatë kohës së gjidhënies nuk duhet të praktikohen dietat e dobësimit.

Një menu shembull për një nënë që ushqen beben me gji, mund të jetë në këtë mënyrë:

Në mëngjes: 1 gotë qumësht, 1 vezë, 5 kokrra ullinj, 1-2 feta bukë, 1 lugë gjelle reçel, 1 frut; gjatë pushimit 1 karotë ose domate.

Në drekë: Gjellë me perime dhe me mish, pilaf, 1 gotë dhallë, një fetë bukë, sallatë; gjatë pushimit, një fetë djathë, bukë, domate.

Në mbrëmje: Supë, peshk ose pulë, kos ose ëmbël-sira me qumësht, gjellë me perime, sallatë, fruta.

Para se të flejë; 1 gotë qumësht ose kos.

Cilat janë ndikimet e veseve te bebja dhe gjidhënia?

Nënat që ushqejnë beben me gji duhet të qëndrojnë larg konsumimit të cigares, alkoolit dhe pirjes së

shpeshtë të çajit dhe kafesë. Sidomos duhani dhe alkooli janë vese shumë të dëmshme, të cilat duhet të lihen para se individët të bëhen prindër. Për dëmet që shkakton duhani dhe alkooli në shtatzani, kemi folur në shkrimet e mëparshme.

Këto vese shtojnë rrezikun e lindjes së parakohshme, abortit, lindjes së bebeve të vdekura. Cigarja luan një rol të rëndësishëm në pakësimin e qumështit dhe lëndët e dëmshme që kalojnë në qumësht e dëmtojnë edhe beben. Nikotina, katrani, karboni, monoksidi (gazi që thithet gjatë helmimit nga soba) janë lëndët më të rrezikshme që gjenden te duhani.

Këto i dëmtojnë njëra pas tjetrës organet e vogla të bebes. Edhe pse bebja duket sikur ka ardhur i shëndetshëm në këtë botë, sindroma e vdekjes së papritur ose siç quhet edhe "vdekja e djepit" te këto foshnja shihet 2-3 herë më shumë se te ato, nënat e të cilave nuk kanë pirë duhan.

Te këta vogëlushë është më e lartë edhe mundësia e lindjes me gjysmë gjuhë apo gjysmë buzë. Është rritur **8-9 herë** rreziku i sëmundjes së rrugëve të sipërme të frymëmarrjes, **15 herë** rreziku i sëmundjes së rrugëve të poshtme të frymëmarrjes, **3 herë** rreziku i infeksionit të veshit të mesit. **Nëse në shtëpi ka edhe presona të tjerë përveç prindërve që pinë duhan, në këtë rast rreziku i sëmundjes së rrugëve të poshtme të frymëmarrjes rritet 40 herë.**

Nuk është zgjidhje që cigarja të pihet në një dhomë ku nuk ndodhet bebja ose në ballkon, sepse nikotina dhe lëndët e tjera të dëmshme të cilat ngjiten në rroba dhe në trup, e dëmtojnë beben sikur të pinte duhan afër tij. Sipas një studimi të bërë në Amerikë, në dhomat e një shtëpie ku pihet duhan, niveli i nikotinës dhe lëndëve të tjera të dëmshme kimike ka konstatuar 5-8 herë më i lartë se në shtëpitë ku nuk konsumohet aspak duhan.

Ndërsa në analizat e urinës që u është bërë bebeve, ka konkluduar 8 herë më shumë lëndë cigareje. Sipas një studimi të bërë mbi foshnjat 6-7 muajsh në "Spitalin e Fëmijëve Dr. Sami Ullus", është konstatuar se më shumë se 60% e foshnjave ndikohen nga cigarja me anë të qumështit të nënës, ndërsa si pirës pasivë, ndikohen edhe nga qumështi i nënës, edhe nga pirja pasive.

Ndikimet e dëmshme të duhanit nuk mjaftohen vetëm me të shkaktuarit e sëmundjeve të infeksionit, në të ardhmen te këta fëmijë mund të zhvillohet anomalia e të mësuarit, veprimeve dhe kujdesit. Në fakt këto vese të dëmshme nuk dëmtojnë vetëm konsumatorët, por edhe njerëzit përreth. Ky ves i keq, i cili e dëmton në mënyrë të ndjeshme beben edhe para edhe pasi të lindë, duhet të lihet para se të bëhemi prindër. Ndërsa nënat që ushqejnë beben me gji, duhet të qëndrojnë larg duhanit dhe njerëzve që e konsumojnë atë.

Prodhimet me të cilat kemi fituar SHPËRBLIMIN KOSOVAR TË PRODUKTIT TË QUMËSHITIT 2005




KONSUMONI PRODUKTE ME CILËSI TË VËRTETUAR

CILËSI E VËRTETUAR



Jogurtat me përmbajtje
të kulturave *Bio Active*
Në Kosovë prodhohet
vetëm nga qumështorja "ABI"

Probiotic
drink



www.abimilk.com

Industria e qumështit "ABI" Prizren-Kosovë

Adresa-Address: "Tirana" N:9, Prizren
Tel & Fax: +381 29 622 356
E-mail: abi@abimilk.com

www.abimilk.com

Industria e qumështit "ABI" Prizren-Kosovë

"ABI" është licensuar nga ana e Agjencisë Veterinare e Ushqimit të Kosovës

Numri i licencës : AVUK-001

"ABI" ka fituar të drejtën për eksport me numrin eksportues : KS-033